



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Kuvendi i Komunës

Nr. 02/ _____

Datë: .14.12.2020

14/12/2020
02/515-

PROCESVERBAL

i mbledhjes së -VII-(shtatë) të rregulltë të Kuvendit Komunal të Malishevës

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i draft Rregullores për Tatimin mbi Pronën e Paluajtshme për vitin 2021 (përsëritur).
2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/813 datë:19.08.2020 të parashtruar nga Kryetari i Komunës,për ndarjen e lokacionit për ndërtimin e stadiumit ndihmës në Malishevë (përsëritur).
3. Shqyrtimi i kërkesës nr.02/277 datë:12.08.2020 të parashtruar nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, në lidhje me vendimin nr.02/05 datë: 10.01.2020 të Kuvendit të Komunës së Malishevës, për pezullimin e pëlqimeve për operimin e kompanive të gurëthyesve (përsëritur).
4. Shqyrtimi i Raportit të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim për periudhën Janar-Qershor për vitin 2020 (përsëritur).
5. Shqyrtimi i Raportit të Drejtorisë për Shërbime Publike për vitin 2020 (përsëritur).
6. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.06/89 datë: 01.09.2020 të parashtruar nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Shërbim Pronëso- Juridik në lidhje me rregullimin e parcelave brenda oborreve të shkollave (përsëritur).

7. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-Rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e të drejtave të Fëmijëve (përsëritur).
8. Shqyrtimi i kërkesës nr.02/255 datë:16.07.2020 të parashtruar nga shefi i grupit të anëtarëve të Kuvendit të Komunës nga radhët e AAK-së, për pjesëmarrje në Komitetet e përkohshme të formuara nga Kuvendi i Komunës (përsëritur).
9. Shqyrtimi i kërkesës nr.02/256 datë: 17.07.2020 të parashtruar nga shefi i grupit të asamblistëve nga radhët e Nismës Socialdemokrate në Malishevë, lidhur me plotësimin e Komiteteve të përkohshme të formuara nga Kuvendi i Komunës (përsëritur).
10. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës nr.01/914 datë:15.09.2020, sipas kërkesës nr.01/137 datë:18.02.2020 të parashtruar nga anëtarët e kryesisë së fshatit Carrallukë, për caktimin e lokacionit dhe përkrahje financiare për ndërtimin e objektit të përbashkët me rastin e organizimit të pritjeve për raste të ndryshme (përsëritur).
11. Ndërtimi i Çerdhes së Re pa vendim të Kuvendit Komunal si dhe caktimi i lokacionit të ri për këtë Çerdhe (përsëritur).
12. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/287 datë:20.08.2020 të parashtruar nga Sylë Morina nga fshati Astrazup (përsëritur)
13. Shqyrtimi i Raportit nëntëmujor Financiar për vitin 2020.
14. Shqyrtimi i Raportit të Drejtorisë për Bujqësi rreth mbjelljeve vjeshtore.
15. Shqyrtimi i Raportit të DKA E-së, për përgatitjet dimërore nëpër shkolla.
16. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/1055 datë:14.10.2020 për marrjen e vendimit, për ndërrimin e pronës publike me pronë private, për interes publik me rastin e ndërtimit të objektit të shkollës fillore në fshatin Panorc, KK.Malishevë.
17. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/45 datë:16.01.2020, të parashtruar nga Kryetari i Komunës, sipas kërkesës nr.09/02-MB datë: 09.01.2019, për caktimin e lokacionit për vendosjen e pikës së transferit, për grumbullimin, transportimin, depozitimin e mbeturinave (jo të ngurta) të cilat grumbullohen nga K.R.M Ekoregjioni Sh.a në Prizren, njësia në Malishevë.
18. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.06/98 datë:25.11.2019 e parashtruar nga Hajdin dhe Ibrahim Shehu nga fshati Maxharrë, Komuna e Malishevës, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
19. Shqyrtimi i kërkesës nr.02/381 datë: 08.10.2020 të parashtruar nga banoret e 4 familjeve Gegaj,Lagja Munishaj- Fshati i Ri.
20. Të ndryshme.

Mbledhja mbahet me datë: 28.10. 2020 dhe filloi në ora 10:15. Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin:
19 asambleistë, drejtorë komunalë, zyra për informim.

Rrahim Morina: Korum kemi, 19 janë prezent në sallë. Fillimisht ju pershendes të gjithëve që jeni të pranishëm në këtë sallë, anëtarët e Kuvendit, anëtarët e kabinetit qeveritar dhe gjithë të pranishmit e tjerë. Hapim mbledhjen e -VII-(shtatë) të rregulltë të Komunës së Malishevës.

Si gjithmonë në fillim e kemi pikën jashtë rendit të ditës. Atëherë hapi debat rreth kësaj pike. Urdhëro, Alban e keni fjalën.

Alban Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Fillimisht kisha dashur t'i falenderoj dy persona, dy zyrtare të administratës Komunale të cilat për arsyet e tyre personale nuk punojnë më në administratën tone. Është fjala për Verë Linda Gashi dhe Samire Krasniqi dhe i falenderoj për punën, angazhimin, kontributin e tyre këtu dhe të ju uroj qdo të mirë në jetën e tyre private dhe profesionale.

Çështja për të cilën dola ktu të flasë, ka të bëjë me një numër të kontratave të cilat janë nënshkruar nga Drejtoria e Urbanizmit, janë negociu nga Zyra Prokurimit fillimisht, por që kanë të bëjnë kryesisht dhe me Drejtorin e Urbanizmit, kanë të bëjnë edhe me Kryetarin. Ato kontrata janë të nënshkruara përmes procedurave të negociuara, pa publikim të njoftimit të kontratës. Këto kontrata zakonisht bëhen vetëm në rrethanat pra sipas ligjit në kuader të prokurimit emergjent dhe ajo qka ka ndodhë është që këto kontrata janë bërë brenda një muaj e gjysë, dy brenda këtij intervali dy mujor. Për natyrën e kontratave të cilat janë nënshkruar dhe janë negociuar, nuk ka pasur arsye që ato të bëhen në këtë mënyrë.

Ato kontrata janë:

- Furnizimi me material higjienik në institucionet edukativo-arsimore, vlera e parashikuar ka qenë 32,000 € ;
- ndërtimi i rrugëve me kubza në fshatrat e Malishevës Loti 2, vlera e parashikuar 8177 € ;
- punimi i kanalizimit nëpër fshatrat e Malishevës Lot 3, vlera 12,000 € ;
- furnizimi me motokultivator për fermerë në Komunën e Malishevës, procedurë e negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës vlera 1140 € ;
- renovimi i nyjeve sanitare në institucionet arsimore me vlerë 30,000€ mirëpo më pas kjo është anuluar si tender ;
- riparimi i ngrohjeve qendrore në institucionet arsimore të Komunës së Malishevës 37,050€.

Unë e kam ngritur këtë çështje se s'i ka mundësi që këto riparime të ndodhin në shifra kaq të mëdha, nëse ka shkolla që ka riparime qdo vit duhet të merren masat ndaj drejtorëve .

Për fund dua t'i përmendi disa copza të ligjit që rregullon prokurimin emergjent. Neni 50.1 thotë rastet emergjente ndahen në dy lloje të emergjencave: emergjenca ekstreme dhe urgjenca.

Rastet e emergjencës ekstreme 50.2 ekziston mundësia që të përdoret procedura e negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës, kjo procedurë zhvillohet me një ose më shumë operator ekonomik, të zgjedhur nga autoriteti kontraktues. Nuk ka afate minimale kohore që lidhen me kryerjen e kësaj procedure. Kushtet e përdorimit të procedurave emergjente janë si rrethanat që nënkuptojnë këto dy pika: domosdoshmëri strikte e zhvillimit të një aktiviteti të prokurimit në bazë emergjente, motivuar nga ngjarje të verifikueshme në mënyrë objektive që nuk ishin të parashikueshme nga autoriteti kontraktues, nuk mund të arrijë afatet kohore të kërkuara dhe rrethanat emergjente që nuk i atribuohen veprimet neglizhente apo qëllimeve të autoritetit kontraktues. Pra ky lloj i prokurimeve, bëhet vetëm në rastet kur janë rrethanat emergjente që dalin aty për aty, nuk kanë qenë të planifikuara dhe jo rrethanat që kanë të bëjnë me neglizhencën e autoritetit kontraktues, qysh është në rastin përkatës.

Këto lloje të prokurimeve që janë bërë nga autoriteti kontraktues komunal janë shkelje e rëndë ligjore dhe nga këtu e ftoj Prokurorin që këto raste t'i hetojë dhe të marrë masa, në mënyrë që

paraja publike mos të keqpërdoret, në mënyren si është keqpërdorur në këtë rast dhe detyra zyrtare e zyrtarëve në fjalë. E ftoj Kryetarin Begaj që të marrë masa të menjëhershme ta ndalë këtë lloj të Prokurimit sepse kjo e dëmton dhe buxhetin Komunal por dhe përbënë dhe shkelje ligjore. Faleminderit!

Rrahim Morina: Sylë Dukolli e ka fjalën.

Sylë Dukolli: Pershendetje Kryesues, pershendetje të nderuar kolegë, ju administrata e ekzekutivit, drejtor. Në këtë pikë të veçantë i kisha theksu disa probleme që po ndeshemi qdo ditë me to. Është duke u rirregullu rruga Kjev-Malishevë dhe si duket ai që e ka marrë për me e rregullu këtë rrugë që nuk është i Komunës tonë, e ka marrë që sivjet veq me ba gropa e në mot me i shtrë. Kërkoj nga inspektoriat që të del në rrugë dhe t'i rregulloj ato që i ka hapur për me i rinovu, ndërsa këtë pjesën tjetër mundësisht ta bëjë menjëher masi t'i hap me i mbyll sepse makinat e qytetarëve po dëmtohen.

Kërkoj nga Inspektoriat Komunal që të marrë masa ose ndonjë rrethoj mbrojtëse të punimeve të zgjerimit të rrugës Pajtimi deri te rrethi, është bërë rrugë shumë e rrezikshme.

Sa i përket fshatit prej nga vi po kemi probleme nga keqbërës të ndryshëm në dëmtimin e aseteve të shkollës, andaj kërkoj nga Drejtoria e Arsimit nëse ka mundësi të na vendos disa kamera të cilat edhe me ndriqimin që është ka mundësi të identifikohen ata persona të pa përgjegjshëm të cilët po e dëmtojnë shkollën. Kërkoj vendosjen e kamerave në shkollën fillore në Bubavec.

Edhe një shqetësim e kam për qentë endacak, kërkoj nga organet përgjegjëse t'i siguroj fëmijët nga rreziku dhe të bëjë qare për qentë endacak.

Dhe unë i bashkangjitem fjalës së parafolës lidhur me dy punëtorët e administratës të Kuvendit, i urojmë suksese këtyre të rinjve që kanë ardhur. Faleminderit Kryesues!

Rrahim Morina: Nebi Bibaj e ka fjalën.

Nebi Bibaj: Faleminderit Kryesues! Të nderuar kolegë asambleistë, përfaqësues të mediave, të dashur qytetarë. Më shqetëson një fakt që vazhdimisht Kryetari dhe nënkryetari i ikin përgjithësisht që i kanë ndaj Kuvendit dhe ndaj qytetarëve, sigurisht i din punët dhe skandalet që janë duke i bërë në vazhdimi dhe nuk janë në gjendje mu përgjigj këtu para tyre.

Çështja e parë që do ta ngris jashtë rendit të ditës është qentë endacak. A duhet të ketë ndonjë rast me fatalitet, për me ndërhy me i eliminu qentë endacak apo qka është puna?

Një qështje tjetër për drejtorin e shëndetësisë, që dy javë rengeli nuk ju punon në QKMF.

Te shkolla Lladrovë është përfunduar moti, por sipas informacioneve që i kemi dritat në shkollën e Lladrovës kanë ardhur drita të përdorura dhe kanë ardhur prej një objekti të Podujevës, kjo për mua është shqetësuese.

Jam kundër këtij vendimi drejtor Mazreku që e keni bërë për shkollat, mos lejmin e shkollave private për me u stervit në stadium të qytetit, për mua është një defirencim i madh.

Kanalizimet të zjarrfiksit ka kohë që është mbi sipërfaqe, prej zjarrfiksave del në asfalt kryesor, është mirë me ndërmarr diqka dhe ato me shti në gypa.

Pusetet në rrugën "Hilmi Hoti", ka qe dy vite ajo puset nuk është punë mu mshel.

Rruga "Adem Jashari" me paleta i keni të mbuluara kanalizimet, kjo është shqetësuese.

Faleminderit!

Rrahim Morina: Fjalën e ka Hidajete Mazreku.

Hidajete Mazreku: Faleminderit Kryesues! Pershendetje kolegë asambleistë, pershendetje drejtorë, pershendetje të tjerë në sallë. Nebih mua po më vjen qudi s'i radiologjia nuk punon, na kemi qenë para 10 ditëve dhe kemi biseduar me ata, ajo nuk është pagesë shumë e madhe, por në shejë që muaji tetor është muaji i kancerit të gjirit. Ne si grup së bashku me zyrtaren për barazi gjinore, grupi i grave kemi shkuar edhe te Kryetari edhe te drejtori që mos ti merr pagesat grave për këtë muaj tetor në shejë simbolike dhe të bëjnë kontrollime brenda këti muaji, dy euro është pagesa është simbolike. Mua po më vjen qud si ka ardhur prishja e ati rengeli ku e kemi një mjeke që është shumë e zellshme që ka marrur për sipër të bëjë kontrollimet dhe në mamograf. Kryesues po më vjen keq që Kryetari nuk është, këto i kisha posaqërisht për Kryetarin, por pasi që është Muharremi po drejtohem këti, ai është kshilltarë i Kryetarit dhe ndoshta mundet me na ndihmu neve grave asambleiste, zyrtares për barazi gjinore e kështu me radhë për mamograf. Mamografi është ble, kemi qenë e kemi vizituar shumë mirë, është riparuar dhe radiologjia, është e ndreq dhe emergjenca edhe mamografi ka hapësirë që të fillojë punën e saj. Brenga ime këtu është që QKMF-ja prej që është i ka 120 puntorë, në vitin 2019 vetëm dy puntorë janë shtu gjithësej 124 puntorë. Muharrem po të pyes ty, në bazë të udhëzuesit administrativ të gjitha Komunat kanë të drejtë për dy mi banorë 1 mjek dhe 2 infermiere, pse Komuna e Malishevës nuk e ka këtë. A ka bërë Kryetari kërkesen te Ministria e Shëndetësisë që të na mundësoj dhe neve ta kemi stafin adekuat për shërbime shëndetësore. Na jemi të anashkaluar nga të gjitha Komunat e tjera përshembull Rahoveci i ka përafërsisht numrin e banorëve sa Malisheva i ka 170 punëtorë. Në bazë të informatave që kisha unë me gjithë stafin edhe grupin e grave asambleiste dhe zyra për barazi gjinore kemi marrur informata se ai mamograf nuk mund të fillojë punën edhe mjekja që 5 muaj ka bërë kërkesë për mu trajnu, sot e kësaj dite halle nuk i jepet drita jeshile asaj mjekes që me shku ajo mu trajnu. Muharrem të lutem me na dhanë këshilla qka të veprojm, nëse ju keni vepruar dhe nuk mundeni me arritë atë që është në Udhëzues Administrativ atëherë ne si grup i grave, zyra për barazi gjinore edhe asambleista, unë do të mbajë mbledhje edhe me asambleista jemi në gjendje të shkojmë drejtpërsëdrejti në zyrën e Ministris së Shëndetësisë edhe të marrim njohuri që sa ata kanë anashkaluar Komunën e Malishevës dhe sa ata janë në gjendje me na ndihmuar posaqërisht me mamograf. Ta jetësojmë atë mamograf që Lëvizja Vetëvendosje është duke luftuar prej vitit 2016.

Kam dhe një shqetësim, ju e dini që biblioteka e qytetit vjet nuk ka punuar për shkak të rrymës, për shkak të nxemjes. Krejt nxënësit, krejt lexuesit që jemi shumë në sezonin e dimrit total është e mbyllur, si me qenë pandemi dimrore. Të lutem Valon qdo herë kemi buxhet për blerjen e librave. Kur Komuna Malisheves ka blerë libra? Librat janë vetëm nga donacionet që janë dhanë. 5.000 euro i kemi për vitin 2020, asgjë nuk është bërë.

Rrahim Morina: Faleminderit profesoreshë! Fjalën e ka Sadije Krasniqi.

Sadije Krasniqi: Faleminderit Kryesues! Pershendetje kabinet qeveritar, pershendetje anëtarë të Kuvendit dhe gjithë ju të pranishëm në sallë. Urime suksese për dy anëtarët e reja të administrates. Kryesues sdi sa herë e kemi diskutur qështjen që duhet të menaxhosh më mirë me Kuvendin me kohën dhe ta zbatosh rregullorën e Kuvendit edhe secili ta ketë minutazhen që i përket, ta shfrytëzoj atë minutazh dhe mos të merr minuta të anëtarëve të tjerë. mirëpo tu jepet mundësia të gjithë anëtarëve të flasin për shqetësimet e tyre. Qe disa herë me radhë dhe jo rastësisht nuk është kjo mbledhja e pare, që sot vim në këtë mbledhje me 20 pika të rendit të ditës, me të vërtet i ka humbur kuptimi edhe këtyre temave edhe këti Kuvendi. Zakonisht

mbledhjet të jashtëzakonshme stërgjatje dhe rezultat jo aq sa duhet me kanë. Andaj Kryesues tu kisha lutur me menaxhu ma mirë me Kuvendin dhe pikërisht është mosaftësia juaj që i kemi këto pika të rendit të ditës kaq numër të madh dhe kaq zgjatje të minutazhes.

Shqetësimi im është gjendja e kanalizimeve në Drenovc është shumë e randë dhe nuk kemi ndonjë veprim. Edhe në Malishevë gjendja e kanalizimeve është jo e mire.

Ne si komitet për barazi gjinore para disa kohësh kemi vizituar fabriken e maskave në Bellanic dhe aty jemi njoftuar për së afërmi me punën që po bahet aty. Mbi 80% të puntorëve në atë fabrik ishin gra dhe kërkesa ime është që ta përkrahim këtë biznes, të ju ndihmojmë atyre grave dhe krejt qka duhet të bëjmë në është që ati biznesi t'i ofrojmë tregun. Kjo është kërkesa ime. Faleminderit!

Rrahim Morina: Faleminderit Sdiqe! Vërejtjen e ke me vend, por spo mundem me ju përmbajt, përmbajuni dhe ju, e dini dhe ju qka është rregullorja. Ilaz Krasniqi e ka fjalën.

Ilaz Krasniqi: Pershendetje për të gjithë, pershendetje për qytetarët e Malishevës! Unë e kam një shqetësim te familja e Dhurates e cila është me nevoja të veqanta, është ftuar nga Komisioni për ta vlerësuar se cila është gjendja shëndetësore e Dhurates dhe pasi që zyrtari i ciklit të ulët në kuader të drejtoris së juaj, drejtor nuk e ka marr parasysh, nuk e ka pranuar dhe më e keqja nga zyrtari juaj është që këtë nënë e nxerr jashtë duke i thënë se nuk kam kohë të mirrem me ty dhe pse e kishte thirrur që të bëhet ai vlerësim. Unë e kam pa vlersimin e komisionit që asaj ja ka caktuar dhe mësuesin me trajtim të veqantë, pra besoj se e din kush është Dhurata. Është shumë e dhimshme kur një fëmijë ose një nënë ka problem me shendetin e fëmijës dhe zyrtari i arsimit i cili thirret në edukimin dhe rregullimin e këtyre qështjeve mu sjell aq keq me nënën e Dhurates, është shqetësim besoj dhe për ju.

Ne sot e kemi dhe një draft rregullorë për përkujdesjen mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve që do ta lexoj nenin e parë , e cila sot do të votohet . Në këtë rregullorë përcaktohen rregullat e procedurat për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës në zbatim të ligjit në mbrojtjen e fëmijës të kompetencave vetanake të Komunës së Malishevës. Mbrojtja e fëmijës nga të gjitha format e dhunës fizike dhe mendore, abozimi, keqpërdorimi, shfrytëzimi, neglizhimi apo ndonjë formë tjetër që vë në rrezik jetën, sigurinë, shëndetin, edukimin , arsimin dhe zhvillimin e fëmijës. Pika 1.2 përcaktimi i detyrave të përgjegjësis të subjekteve të mbrojtjes së fëmijës s'i dhe mënyra së kordinimit, raportimit dhe bashkëpunimit të tyre me qëllim të kontributit të sistemit të fëmijës s'i dhe kontributin për krijimin e një Komune mike me fëmijët .

Kërkesa dhe shqetësimi i bizneseve në Malishevë e veqmas i atyre që ushtrojnë veprimtari afër rrethit dhe stacionit të autobusëve të Komunës së Malishevës, ku ato biznese kanë bërë kërkesë edhe te Drejtori i Inspektoritativit edhe te Drejtori i Policisë sepse muzika që krijohet diku me një objekt aty ju krijon probleme në ushtrimin e veprimtarisë së tyre. Unë e kam njoftuar dhe drejtorin që është këtu edhe Zv.Komandantin e Policisë, por zv.komandanti i Polocisë na thotë se ne nuk kemi një aparat që mat volumin e zërit dhe nuk mund t'i marrim masat.Komuna ose inspektoriat duhet ta ketë atë aparat i cili nuk po kushtojke më shumë se 200-300 €, dhe përderisa na mungon ai aparat nuk mundemi me kry masat që duhet me i ndërmarrë.

Shqetësimi tjetër është që Kryetari gjatë emisionit Jeta në Kosovë thotë se nuk ka fshat, nuk ka lagje në Komunën e Malishevës që nuk janë shtruar rrugët kryesore, unë po ja përmendi Kryetarit se lagjja "Behraj" në Carrallukë nuk ka rrugë kryesore të shtruar por nuk ka asnjë investim të Komunës as trotuar, as ndriqim, as kanalizim, dhe pse i kemi paraparë në projekt-buxhetin e vitit të kaluar 400 metra rrugë të shtrohen asaj lagje, prapë është shtyr për vitin tjetër.

I vetmi shërbim që i bëhet asaj lagje është Ekoregjioni dhe ata në kohën e verës jo të dimrit. Ishte dhe një përgjigje e Kryetarit ku thotë se nuk ka asnjë të infektuar me Covid-19, në Vërmic është kërkuar ndihmë nga QKMF-ja është shku ekipi me gjitha paisjet dhe nuk ka hyrë brenda për arsye se rrezikojmë. Faleminderit !

Rrahim Morina: Faleminderit Ilaz! Fjalën e ka Behije Sertolli.

Behije Sertolli: Pershendetje për kolegë asambleistë, të pranishëm në sallë, drejtor. Një shqetësim është duke ju drejtuar ekzekutivit sidomos nga qytetarët e Bellanicës, ka të bëjë me qësjtjen e gurthyesve që është duke operuar në Bellanicë. Siq e dimë Malisheva ka qenë shumë dorë lire në dhënien e këtyre pëlqimeve për operimin e këtyre gurthyesve në territorin e Komunës sonë, janë dhënë pëlqimet pa shikuar detajet që do t'i sjellin këto biznese ndaj popullates që jetojnë aty. Një gjë e tillë ka ndodhur edhe me qytetarët e Bellanicës, ku në vitin e kaluar Drejtoria Komunale e Urbanizmit kishte dhënë pëlqimin për operimin e gurthyesve në fshatin Bellanicë. Banorët shprehin revoltën e tyre dhe përmes peticioneve dhe formave të tjera kërkuar largimin e këti gurthyesi, me një kërkesë të tillë banorët ju drejtuan dhe asambles Komunale e cila ju doli në ndihmë, duke kërkuar nga Kryetari të tërhiqet pëlqimi i dhënë për këtë gurthyes. Para 3 muajve Drejtoria e Urbanizmit e tërhoqi pëlqimin e dhënë, kjo ishte një veprim i mirë, por ajo qka është shqetësuese Inspektorët Komunal asnjëherë nuk dolën në vendin e ngjarjes për ta ndaluar punën e këtij operatori.

Çka keni bërë gjatë këtyre muajve, deri sa është hekur pëlqimi dhe ju nuk keni dalur aty ku ka filluar punën gurthyesi? Drejtori i fshatit ka kërkuar nga ekzekutivi, nga inspektoriat i që të dal në vendin e ngjarjes sepse është duke operuar dhe pse është tërhekur pëlqimi. Pse nuk keni marrur masa ?

Rrahim Morina: Ajo qka është pikë e rendit të ditës përmbanu, kur të vjen ajo pikë debatojmë. Raimonda Krasniqi e ka fjalën.

Raimonda Krasniqi: Pershendetje për gjithë të pranishmit! Rreth afërsisht dy muajve për shkak të kushteve atmosferike, erërave të forta është hequr një pjesë e qatis e objektit banesor Dardania përballë Kuvendit Komunal. Ka qenë rrezik për qytetarët shpërndarja e materialit të qatis, por ajo është diqka që ne nuk e kemi në dorë. Pjesët janë shpërndarë deri tek monumenti i Adem Jasharit, në asfaltin kryesor për tek muzeu, në pjesën e përparme të muzeut dhe në oborrin e banesave kolektive mbi automjete. Ka pasur dëme të pakta të automjeteve, ndërsa rrezikshmëria ndaj jetës së qytetarëve është shmangur. Çfarë kanë ndërmarrë Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Emergjences në këtë rast, kur ekziston një fond për raste emergjente të tilla sepse qe dy muaj nuk është bërë asgjë dhe banorët janë të rrezikuar se ju janë dëmtuar banesat. Çka kanë ndërmarrë këto dy drejtori dhe qfarë procedura kanë ndjekur drejtoria e inspektoriatit për të paditur kompanin përgjegjëse e cila ka kryer ndërtimin e këtyre banesave ? Unë kam biseduar veqanarisht me drejtorin ka thënë nuk është detyre e jona, është detyrë e juaja sepse keni nënshkruar një marrveshje me atë operatorin që ka ndërtuar këtë objekt banesor. Është mirë që ju të ndërhyni sa më shpejtë në rregullimin sepse pjesa e mbetur lëvizë. Çështja tjetër është diskriminimi i mësimeve në rastin e pagesës së shujtes dhe pagave jubilarë, si është vepruar në këtë rast, Drejtori i Arsimit mund të na jep shpjegime, pasi që avokati ka pasur kontakte gjithmonë me drejtorin arsimit për kryerjen e pagesave. Pse nuk janë paguar të gjithë?

Ne kemi aplikuar gjithë në të njejtën kohë, e kemi qar dokumentacionin të gjithë të njejtë me ditët e punës të mësimit që kemi mbajtur në ato shkolla. Pse nuk është bërë pagesa për shkollë në tërësi, por janë ndarë një pjesë e mësimeve dhe pjesa tjetër nuk është paguar? Pse nuk janë paguar pagat jubilarë dhe a priten të pagohen këto paga? Në këtë asamblë ne kemi marr një vendim mbi 120.000€ i kemi ndarë për pagat jubilarë, na ka ardhur njoftimi nga Ministria e Financave që nuk i kanë lejuar që të bëjnë pagesat jubilarë me ato para. Çfarë ka ndodhur me ato para?

Para një jave Komuna e Malishevës në faqen e saj ka reklamuar se ka marrur në punë 30 persona, në bazë të një marrëveshje me Ministrin e Punës dhe Mireqenies Sociale dhe Agjensionin e Punësimit, unë ju uroj suksese dhe ky numër 30 të bëhet 3.000 sepse kemi shumë të ri e të reja që po shkollohen dhe janë të pa punë, por dyshoj shumë se si është bërë përzgjedhja. Si janë pranuar në punë këta 30 persona, qfarë kriteresh janë prezantuar, a ka pasur ndonjë konkurs apo si është vepruar, qfarë kriteresh kanë plotësuar personat e punësuar, për sa kohë do të punojnë këta persona, a janë me kontrat apo pa kontrat, nëse janë me kontrat sa është kjo kontrat, a është 3 muaj, 6 apo 1 vit? Faleminderit!

Rrahim Morina: Alban Mazreku e ka fjalën.

Alban Mazreku: Pershendetje Kryesues! Të nderuar asambleistë, të nderuar qytetarë të Komunës së Malishevës, të nderuar drejtor. Sa i përket qështjes së vendimit të marrë nga Drejtoria për Rini dhe Sport ku shkollave të futbollit që operojnë në Komunën e Malishevës në një farë mënyre ju ndalohet për disa grup mosha ushtrimi i veprimtarisë ose ushtrimeve të tyre në fushën e futbollit. Unë personalisht me sa e njoh Drejtorin e drejtoris së rinis ky është me të vërtetë një sportdashës i jashtëzakonshëm dhe nuk besoj që është vendim direkt i drejtorit mirëpo mund të jetë i shtyrë nga Kryetari i Komunës i cili vjen nga Nisma Social-Demokrate dhe i cili i ndalon aktivitetet sportive të rinis sonë. I kisha bërë thirrje publike drejtorit rinis dhe kultures zotit Mazreku që ta heq këtë vendim sepse dhe në atë vendim nuk ka ndonjë arsyeshmëri se pse janë ndaluar, vetëm mbështeten në disa nene ligjore të ligjit për vetëqeverisje lokale dhe ligjet për financa publike për vetëqeverisje lokale, gjë që nuk përkojnë me vendimin që e kanë marrë për ndalimin e aktiviteteve të tyre.

Drejtorin Ahmet nuk e kemi këtu, në fshatin Astrazup rruga që shkon në drejtim të lagjes lartë ku po thojnë që kanë me i maru do varreza të reja është një rrugë që është shtruar me gjatësi të gjatë mirëpo nuk ka vendbanim atje, realisht veq ka shku asfalti e vendbanim nuk ka.

Rruga e “ Refugjatëve në fshatin Pagarushë ku janë shtruar trotuar në anën e majtë të asaj rruge, nuk i kanë lënë asnjë përcjells të ujit, unë e kam taku drejtorin e financave dhe kam kërkuar që të merren masa ndaj atyre që e kanë punuar atë rrugë, mirëpo prapë vazhdon të jetë i njejtë ai trotuar.

Ndriqimi në lagjen “Dukojt” dhe pse është ndarë fondi për rinovim të ndriqimeve publike, dritat janë të vendosura mirëpo nuk janë në funksion.

Fshati Drenovë që lidhet me pjesën e Vërmices e dinë dhe drejtori Milazim rruga është në gjendje jashtëzakonisht të keqe, i kisha lutur drejtorin e urbanizmit që të ndërmerr masa në atë rrugë. Rruga “ Hamdi Berisha” në hyrje të shkollës fillore “ Ibrahim Mazreku” është një grope gati 1 vitë e gjysë dhe është shumë keq. Rruga “ Luftëtarët e UQK-së është në gjendje jo të mire dhe kjo vjen si pasojë e dëmtimit që e bë në kompania rajonale e ujësjellësit e cila i dëmton rrugët dhe nuk i kthen në gjendjen e mëparshme. Rruga “Pavarësia” që është duke u rregulluar është mirë që të parashihet dhe zhvendosja e shtyllave elektrike edhe pse janë në gjendje shumë

të keqe, është mirë me i zhvendos ato në bashkëpunim me KEDS-in me ba një marrëveshje. Rruga “Xhevdet Sahitaj” në fshatin Panorë lagjia “Garaqevë” me kerre është shumë e vështirë me dal prej asaj rruge atje, në projekt buxhetin e vitit 2020 implementimi i ndriqimit publik ende nuk janë vendosur trupat, së paku 10 trupa ndriquese.

Në debatin që e kemi pasur te jeta në Komunë me Jeta Xharra Kryetari i Komunës në bashkëpunim me drejtorin e urbanizmit Ahmet Morina ka thënë se në Malishevë nuk ka rrugë më shumë se 150 metra në qytet që janë të pa asfaltuara, një prej tyre është rruga “Lumnaja” që shkon te profesori Muharrem Mazreku si dhe vazhdimi i rrugës është në kryt ku është Isufi krahu i djathtë është e pa asfaltuar dhe vazhdimi i rrugës “Jahir Mazreku” dhe kjo është e pa përfunduar.

Komuna jonë është një prej Komunave që nuk ka sheja pothuajse fare as në qytet as nëpër fshatra, më e keqja është që te asnjë vendkalim për këmbësorë nuk është e shënuar vendosja e shejes për këmbësor. Çështja e trotuarit në fshatin Llazicë dhe atje është shtruar në anën e kundërt dhe grumbullohet uji në rrugë kryesore afër shkollës.

Kryetari i Komunës e ka pas krijuar një komision për vlerësimin e dëmeve të pandemis të bizneseve në Komunën e Malishevës, ne nuk e kemi një raport të atij komisionit qfarë vlerësimi ka bërë të dëmeve.

Një kërkesë e kam për drejtorin e financave, tu kisha lutur që në bashkëpunim me policinë e Kosovës, stacionin policor në Malishevë të bëhet një kontrollë pak më i rreptë i lokaleve që operojn afër shkollave “Hamdi Berisha” dhe “Ibrahim Mazreku”. Aty dyshimet janë që përveq disa lokaleve që japin cigare me copa për nxënës që nuk i kanë as 18 vjeç, dyshohet se mund të përdoret edhe substance narkotike. Faleminderit !

Rrahim Morina: Halil Morina e ka fjalën.

Halil Morina: Faleminderit Kryesues për fjalën! Të nderuar drejtor, të nderuar kolegë asambleistë. Unë i kam dy shqetësime, njëri ka të bëjë me shqetësimin brenda salles që e përmendi zonja Sadije dhe një shqetësim tjetër që e përmendi zonja Raimonda. Është e vërtetë ajo që e tha Raimonda me problematikën që është shkaktuar për shkak të zbatimit të kontrates kolektive. Mësimdhënësit po maltretohen prej avokatëve të ndryshëm, prej palëve të treta. Drejtor i Arsimit e ju ekzekutiv dhe na si Kuvend duhet me gjetë një alternative që këtë punë me kryer na si Kuvend Komunal si Komunë. Pse me fitu palët e treta prej pareve tona, fiton përmbaruesi prej pareve të buxhetit Komunal, fiton avokati prej kontrates kolektive të mësimdhënësit. Imagjinoni veq me 100 mësimdhënësa sa i ka gjimnazi, avokati i fiton 25.000€, mësimdhënësi i fiton 500€. Pse avokati me i fitu paret tona? Pse përmbaruesi me fitu prej buxhetit komunal? Ne duhet me gjetë një alternative si me zgjidh këtë problem. Shqetësimi tjetër ka të bëjë brenda salles, ne vetë duhet me ju nënshtruar e me i respektuar rregulloren e Kuvendit së pari, ligjin për vetëqeverisje lokale e pastaj me dal me i thirr tjerët në përgjegjësi, nuk mujna me i thirr tjerët në përgjegjësi duke i shkelur vetë me dy këmbët qoftë ligjin për vetëqeverisje lokale qoftë rregulloren. Sa pika i kemi të rendit të ditës që janë të bartura prej seancave të kaluara. Kjo ndodhë për shkak të mos menaxhimit të kohës. Kryesues ti po thu që duhet na vetë me respektuar, na të kemi qitur aty për atë punë, duhet me ba presion. Ju faleminderit!

Rrahim Morina: Në rregullore thotë: Keni të drejt të paraqitni vetëm një shqetësim, anëtarët e Kuvendit i kanë 2 minuta ndërsa shefat e grupit i kanë 3 minuta. Blerim Thaqi e ka fjalën.

Blerim Thaqi: Përshendetje për të gjithë! Ishte një shqetësim te qështja e fëmijut, sot për herë të parë e dëgjova, u mundova me kontakruar me zyrtarin për këtë qështje, nuk ka njohuri as ai. Asnjë vërejtje apo kërkesë nuk e ka bërë askush mirëpo do ta trajtoj këtë qështje. Nuk ekziston formë, mënyrë që ju mundeni me nda pare prej kapitaleve apo kodeve të veqanta . Nuk ka instrucion asnjë Komunë që ka da pare me vendim të asambles dhe janë paguar mësimdhënësit, diskriminimi i këtyre pagesave që po bahet është duke u bërë prej avokatëve dhe përmbaruesve. Proceduarat kanë filluar në mënyra të ndryshme, nuk kanë filluar krejt mësimdhënësit njëjtë. Mjetet do të dalin në forma të ndryshme sepse nëse dikush ka filluar ankesën më herët shujta ka me marr më pak sepse për një vit e gjysmë e ka ba, kur ka fillu procedure e ankesës deri aty do t'i merr. Përmbarusit dhe ky thesari i famshëm i ditëve të sotme ka bërë gabime teknikisht në caktimin e vlerave monetare të mësimdhënësit, ka mësimdhënës që ju ka ndar dyfish shujta dhe të gjitha ato që nuk janë në përputhje me ato qa i takon qdo mësimdhënësi ato janë refuzuar. Një faze që i ka marrur mjetet është për vitin 2017 janë 8 muaj dhe 2018, nuk i kanë realizuar 2019 dhe prapë do të fillon procedura dhe do t'i realizon ato. Dhe për pagat jubilarë Komuna i ka të ndara prej qeverisë vetëm për pagat përcjellëse diqka tjetër nuk ka. Për vitin 2018 që thatë 120.000 është kry obligimi për mësimdhënësit, tash pritet vetëm për këta 2020. Asnjë obligim për paga përcjellëse nuk ka. Ju faleminderit !

Rrahim Morina: Faleminderit drejtor! Atëherë kalojmë për rendin e ditës. Sylë Dukolli e ka fjalën.

Sylë Dukolli: Kryesues shumica e pikave të rendit të ditës janë të përsëritura. Unë kam një kërkesë që pika 17. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës i parashtruar nga Kryetari i Komunës për ndarjen e lokacionit, për vendosjen e një pike të grumbullimit të mbeturinave, kisha thënë me kaluar në pikën e parë . Unë jam i pa kënaqur me me pikën e Panorcit që e keni lënë vonë.

Rrahim Morina: Urdhëro ,Alban Mazreku e ka fjalën.

Alban Mazreku: Kryesues, kërkesë e grupit tone parlamentar të Partis Demokratike të Kosovës në Malishevë është që nga rendi i ditës të tërhiqet komplet pika e Panorcit, për arsye që është në procedure gjyqësore, përndryshe ne e përkrahim kërkesën e Sylë Dukollit mirëpo duhet të tërhiqet pika e Panorcit pasi që është në procedur hetimore. Pika e 16 të hiqet nga rendi i ditës.

Rrahim Morina: Alban Krasniqi e ka fjalën.

Alban Krasniqi: Unë i kam dy propozime për dy pika të rendit të ditës. E para ka të bëjë me nxjerrjen e një vendimi nga Kuvendi Komunal, pra që Kuvendi Komunal sot të diskutojë dhe të nxjerr vendim për lejimin e shfrytëzimit të stadiumit të futbollit “Liman Gega” dhe hapsirave tjera sportive për shfrytëzim, trajnimit, ushtrimeve por edhe të zhvillimit të ndeshjeve zyrtare të klubeve sportive dhe shkollave sportive përfshirë dhe ato të futbollit. Me nxjerrjen e këti vendimi ne e anulojmë vendimin e nxjerr nga drejtoria e Kultures dhe ja mundësojmë këtyre klubeve dhe shkollave që t'i zhvillojnë aktivitetet e tyre aty ku i kanë zhvilluar deri tani. Drejtor nuk ke drejt me qitë reklama dhe me i nxjerr njerëzit para kamerave kur ndahen fonde të caktuara. Harroni këto praktika.

Çka nënkupton ky vendim? Është që ju bashkë me klubet sportive edhe shkollat sportive takoheni dhe dy elemente për mendimin tim janë të rëndësishme t'i trajtoni: hapsirën kohore që

duhet me pas sipas mundësive që e ka stadium por edhe fushat e tjera sportive që i kemi ndërtuar për shkollat të shfrytëzohen pas orarit të mësimi. Aty ku nuk plotësohet orari brenda stadiumit të plotësohet në shkolla dhe mund të bëhet me rotacion brenda stadiumit, pra një javë ushtronë një shkollë, javën tjetër shkolla tjetër.

E dyta ka të bëjë me kulmin e ndërtesës kolektive kë tu në qendër të Malishevës, të futet në rend të ditës ndarja e mjeteve për rregullimin e kësaj. Propozoj që të futet në rend të ditës ndarja e mjeteve për renovimin e kulmit të ndërtesës kolektive Dardania.Shumen se sa e ndajmë le të na vjen prej drejtorive përkatëse në bazë të raportit që ata e kanë nxjerr. Sa i përket kërkesës së Syles që pika 17 të vjen e para, është vetëm një problem ne duhet ende me trajtuar aspektin ligjor të saj, gjithashtu nuk janë ardhur dokumentet e qarta se për qfarë zonash jemi duke folur.

Rrahim Morina: Faleminderit Alban! Nga LDK-ja fjalën e ka Arlind Morina.

Arlind Morina: Pershendetje Kryesues, pershendetje anëtarë të Kuvendit! Ne LDK-ja jemi pro këti rendi të ditës, vetëm me heqjen e pikë s së 16 nga rendi i ditës.

Rrahim Morina: Luan Kryeziu e ka fjalën.

Luan Kryeziu: Faleminderit Kryesues! Te çështja e pikes së parë, ka qenë e zakonshme me ardhur procesverbal, unë e vërejta që në këtë rend të ditës nuk është procesverbal. Kryesues, ka qenë mirë me sjellë procesverbalin. Në pikë të rendit të ditës kisha kërkuar që të jetë dhe çështja e kontratave në vepër që janë marruar nga ana e Qeveris Komunale ose të lihen për një mbledhje tjetër dhe të përgaditet një raport në lidhje me procedurat se s'i janë marrur këta persona në kontratë në vepër, kur e dim që ligji e përcakton që duhet të shkohet nëpërmjet prokurimit me u shpallë konkurs në lidhje me pranimin e personave në kontrata në vepër. Kryesues, sa e vërejta këtu, ku së bashku me qeverin komunale kërkesat e qytetarëve i keni qitur në fund të rendit të ditës, ku ne jemi falë tyre këtu në asamble por dhe ju si qeveri komunale. Është mirë që qytetarët në të ardhmen me ju treguar vendin, për shkak të trajtimit të kërkesave të tyre në këtë formë. Faleminderit !

Rrahim Morina: Luan, procesverbal nuk është gati, në momentin kur të është gati do e sjellim. Sylë Dukolli e ka fjalën.

Sylë Dukolli: Sa i përket parafolesit që tha pikat kryesore të qytetarëve po i leni mbrapa, unë isha ai që dola dhe kërkoja me marr një pikë dhe me qit në rend të parë , këta e bajnë KPF-ja, Kuvendi që i ka votat ma shumë.Kisha pasur dëshirë t'i japim kahje kësaj pike.Unë jam për ndërtim, për ndëshkim për ata që i bëjnë gabimet. Kështu nuk i bashkojm idet, kështu kemi vetëm ndarje. Faleminderit!

Rrahim Morina: Avdi Morina e ka fjalën.

Avdi Morina: Faleminderit Kryesues! Pershendetje kolegë, të nderuar drejtor! Unë desha mu ndërlihdhë me një diskutim që ka të bëjë për shkollat e futbollit ose aktivitetet që t'i ushtrojnë në shkolla. U propozua nga Albani që të jetë pikë e rendit të ditës dhe un pajtohem që ne si grupe politike bashkarisht kur ka mendime pozitive unë e përkrahi, kishte me qenë më mirë ta shtyjim për një ditë tjetër. Të ulemi bashkarisht dhe të ju krijojm mundësi.

Unë kam dhe një propozim që sponzorit kryesor që është duke e mbajtur klubin e futbollit Malisheva që ka shpenzime marramendëse, ndoshta t'i jipet në menaxhim stadium që të kujdeset, mos të dëmtohet dhe një pjesë e kohës dhe shkollat e tjera ta ushtrojnë aktivitetin. Faleminderit!

Rrahim Morina:Përgadituni për votim ju lutem!

Propozimi i parë është i Sylë Dukollit i cili ka kërkuar që pika e 17 të vendoset pikë e parë e rendit të ditës, fjala është për pikën e transferit të mbeturinave në Komunën e Malishevës. Kush është për me ngritje të dores?

Për: 15

Kundër: 2

Apstenim: 4

Atëherë kalon pikë e parë e rendit të ditës.

Propozimi i Alban Mazrekut: ka kërkuar që të hiqet pika e 16 pika e Panorcit e cila është mbështetur nga Vetëvendosja, LDK-ja dhe Aleanca. Atëherë kush është që pika 16, çështja e shkollës së Panorcit të hiqet nga rendi i ditës.

Kush është për?

Për: 13

Kundër: 4

Apstenim: 3

Me 13 vota për largohet nga rendi i dites .

Propozimimet e Alban Krasniqit: Lejimi i ushtrimeve për gjitha ekipet,klubet dhe shkollat në nivel të Komunës t'i kryejn ushtrimet në stadiumin “Liman Gega” në Malishevë.

Kush është për?

Për: 18

Kundër: 0

Apstenim: 3

Ky propozim hynë në rend të dites.

Propozimi tjetër është :Ndarja e mjeteve për renovimin e kulmit të objektit Dardania në Malishevë. Kush është për me futur në rend të dites?

Për: 7

Kundër: 14

Apstenim: 2

Kjo pikë nuk futet në rend të dites.

Propozimi i Luan Kryeziut: Kërkon që të futet në rend dite debat rreth pranimi të punëtorëve në kontrat mbi vepër. Kush është për?

Për: 14

Kundër: 7

Apstenim: 2

Ky propozim futet në rend të dites.

Kush është për rendin e dites komplet :

Për: 14

Kundër: 6

Apstenim: 4

Shihemi në ora 13:00

Rrahim Morina: 18 janë prezent. Hapim debat rreth pikës për Ekoregjionin, për pikën e transferit. Materialin ju kam përcjellë dhe atë që është marrë ne e kemi dërguar dhe në Ministri për konfirmim të ligjshmërisë, e keni të bashkangjitur në material. Atëherë, hapim debat rreth kësaj pike. Kush e do fjalën? Drejtori e ka fjalën.

Milazim Morina: Pershendetje Kryesues, pershendetje deputet dhe ju gjithë të pranishëm! Kjo kërkesë është që sa kohë, që deponia e transferit të mbeturinave të Malishevës të largohet. Ne si drejtori kemi qenë të angazhuar që ta gjejmë një pikë tjetër të transferit të mbeturinave, mirëpo dhe dy –tri herë ju kemi drejtuar juve si Kuvend, të gjendet një pikë e transferit të mbeturinave. Kuvendi me kërkesë tonen ju ka drejtuar edhe Ministris që të caktohet një lokalitet , ndërsa Ministria ju ka përgjegjur kërkesës së Kuvendit që të plotësohen disa kushte sidomos pika e transferit kishte qenë e cekur që të jetë në Planin Zhvillimor të Komunës, kurse në Planin Zhvillimor nuk është e parapame që të caktohet një lokacion. Unë dy herë kam qenë në Ministri që të na jape disa të dhëna edhe si Komunë, si Kuvend është e lirë të caktohet një vend mirëpo më kanë thënë që pa u plotësuar kushti që të hyjë në Planin Zhvillimor nuk ju japim kurrfar dokumenti. Kisha kërkuar që të caktohet një lokacion. Ju faleminderit!

Rrahim Morina: Alban Krasniqi e ka fjalën.

Alban Krasniqi: Faleminderit Kryesues! Ne sot e kemi përpara nesh një kërkesë të Drejtoris së Shërbimeve Publike, që ka rrjedhur prej kërkesës së kompanis publike të mbeturinave Ekoregjioni, njësia në Malishevë. Në mbledhjen e Komitetit për Politik dhe Financa ne kemi kërkuar dokumentet përkatëse që neve na mundësojnë t'i marrim këto vendime dhe të sigurohemi se marrja e tyre të jetë e bazuar në ligj. Nga ato hulumtimet që i kam bërë vetë, në mungesë të informacioneve , në vazhdimësi kam kërkuar nga drejtori por nuk na kanë ardh me arsytimin që dhe drejtori tashmë e tha. Vetëm 4 Komuna e kanë pikën e transferit, dy prej tyre janë Drenasi dhe Ferizaji dhe e kam inkuraju dhe drejtorin që të kontaktoj edhe me Komunat në mënyrë që dhe ne ta shohim se si ka shkuar një procedur e tillë, por prapë nuk ka informacion. Kjo kërkesë na ka ardhur dhe më herët, kur i kemi kërkuar informacionet shtesë, tash jemi prapë përballë debatit ose vendimarrjes, shqyrtimit për ndarjen e kësaj pike. Ne e kemi një plan orientues që e kemi votuar në këtë Kuvend Planin Zhvillimor Komunal dhe vendimarrja jonë duhet të bazohet në planifikimet që i kemi pasur në Planin Zhvillimor Komunal. Operimi aktual i asaj pike është i jashtëligjshëm dhe Drejtoria e Inspektoriatit në vazhdimësi ka dështu me kry detyrën e saj në ndalimin e operimit të asaj pike grumbulluese ilegale, ndonëse i ka bërë disa vizita. Me ligjin për Vetëqeverisje Lokale mund të marrë vendime për sa i përket ndëtimimit dhe menaxhimit të mbeturinave, në kuptimin e krijimit edhe të vendeve ku mundet Komuna me sortu mbeturinat, në mënyrë që ato të jenë edhe në kuader të politikave të riciklimit dhe të mbrojtjes së mjedisit . Çka duhet me trajtuar bashkarisht në këtë pikë është vendimi jonë, që aty ku mendojmë që është më e përshtatshme, të marrim vendim që bashkë me pikën e transferit të bartet në tërësi edhe lokacioni i njësisë Ekoregjioni , pra ajo të hiqet.

Ne do duhet ta merrnim një vendim që bashkë me këtë vendin ku bëhet transferi apo grumbullimi i mbeturinave, të vendoset në afërsi të saj dhe kompania e Ekoregjionit, ndërtesa dhe mjetet me të cilat ajo kryen shërbimet . Në ato propozimet që unë i kam vërejtur këtu dhe bazuar në vendodhjen e deponis kryesore të mbeturinave që është Landovica , pozicioni më i përshtatshëm në të cilin dhe Bechtel Enka e ka përgaditur në një fare mënyre terrenin është destinacioni që e ka më afër autostraden.Vendimarrja duhet të jetë në ato hapsira ku janë të përshtatshme edhe për vendosjen e ndërtesës së kompanies por edhe në ndërtimin e kësaj pike të transferit .

Mendoj se ne gjithë së bashku përfshirë dhe drejtorin në këtë proces të rrugëtojmë të gjithë së bashku dhe ta shohim që pas vendimit tone cili do të jetë përgjigjja e Ministries, por nëse drejtori ballafaqohet në pamundësi në rregullimin e dokumenteve, nëse i vyen ndihma e jonë si shefa të grupeve dhe bashkë me Kryesuesin mujm me shku me pasur një takim në Prishtinë me vendimmarrësit, që të konsultohemi saktë se cila do të ishte rruga më e përshtatshme . Vendimin që e marrim duhet të jetë në përputhje me Planin Zhvillimor Komunal, aktualisht në PZHK nuk kemi të parapamë deponi të grumbullimit, pikë të transferit. Faleminderit!

Rrahim Morina: Shefave të grupeve ju përcjellim harten me ngjyra për tri lokacione që i ka propozuar qeveria Komonale dhe konfirmimin ligjor që na ka kthyer Ministria e administrimit të pushtetit lokal. Sylë Dukolli e ka fjalën.

Sylë Dukolli: Sa i përket transferit apo ati grumbullimit të mbeturinave pastaj që barten për Landovic, ne duhet me dhanë të gjithë kontributin këtu. Unë mendoj që në parim mund ta zgjedhim një nga këto parcelat që i kanë ndarë në fshatra të ndryshme. Realisht është mirë me ndodhë dhe një dëgjim publik afër ati fshati në të cilën caktohet, sepse ne duhet me marrë dhe pëlqimin e banorëve që janë në fshat të kësaj baze të transferit të mbeturinave ndërsa kjo baza që ekziston afër zyreve të tyre është pengesë. Ajo bazë duhet të hiqet sepse është në vendbanime.

Sa i përket këtyre pikave, nuk e di te ky lokacioni te Baja sa janë afër vendbanimet e gjithë territorit të Malishevës ku mbledhen mbeturinat, duhet dhe një fakt me marrë parasysh, a i përgjigjet atyre bartjeve deri te pika e transferit , me shpenzime më të ulëta lokacioni i Bajes . Parashtruesit e kërkesës është dashur me ardh me një verzion më të afërt dhe atje me u mbajt një dëgjim publik. Faleminderit !

Rrahim Morina: Faleminderit Sylë! Vetëm një sqarim, ne e kemi qu në konsultim paraprak nuk kemi marrur vendim si Kuvend dhe kemi kërkuar a kemi të drejtë si Komunë, si Kuvend me nda lokacionin për një pikë transferi, përgjegjësjen e kemi marrur. Me PZHK nuk është e planifikuar pika e transferit dhe kjo është e kundër ligjshme qdo vendim që e merrni . Urdhëro, Hashim e keni fjalën.

Hashim Vrenezi: Pershendetje për të gjithë! Ne sot e murrum këtë shpjegim që e keni qu në konsultim paraprak dhe sipas këti shpjegimi po i bjen që qfardo vendimi që e marrim ne, është i kundërligjshëm dhe ku është lokacioni është e kundërligjshme. Këtu duhet me dhënë një shpjegim ndoshta dhe Muharremi me na ndihmu pak, ose me shku me ba një konsultim edhe me zyrtart ligjor atje dhe me ju shpjeguar situaten si është gjendja në Malishevë, ose në qoftëse ka ndonjë mundësi mos me pas pikë transferi hiq, vetëm me e ba grumbullimin e mbeturinave dhe me i transferu drejt në vendin ku e kanë destinacionin Ekoregjioni. Neve na ka ardhur një kërkesë që është jo e kompletune dhe ne në parim e kemi përkrahur këtë iniciativ dhe duhet me hek lokacionin e mbeturinave prej qytetit të Malishevës. Këta na kanë pru disa masa, disa parallogari dhe na është thënë që ky investim do të kryhet prej kompanis së Ekoregjionit , por hapsira që e kanë kërkuar për mendimin tim, nuk është e shpejguar mirë janë 30 deri në 40 ari, është një diferenc shumë e madhe. Kjo nuk po më pëlqen, duhet me saktësu saktë cila është hapsira dhe pse ju vyn një hapsirë kaq e madhe, nëse është veq pikë e transferit unë mendoj që nuk ju duhet hapsirë shumë e madhe sepse sa më e madhe të jetë hapsira, ndoshta

transferimi i këtyre mbeturinave ka me kanë më i rrallë dhe ka me pasur grumbullim të mbeturinave më të madh dhe ka me pasur ndotje të ambientit më të madh. Ndoshta duhet me ba një analizë, që pika e transferit mos me pas ndonjë sasi të madhe të grumbullimit të mbeturinave, por në baza ditore transferimi i mbeturinave me u përcjellë në Landovic, ku e kanë destinacionin përfundimtar ato. Un jam për mbajtjen e dëgjimit publik në lokacionin ku do të vendoset kjo pikë. Paraprakisht ish kanë mirë që përveq zyra të Ekoregjionit me pas një ide se qka dojna me ba dhe me mbeturinat e ngurta, a munden Ekoregjioni me i trajtu dhe këto kategori të mbeturinave. Faleminderit !

Rrahim Morina: Muharremi e ka fjalën.

Muharrem Morina: Faleminderit Kryesues! Pershendetje anëtarë të asambles. Nuk ka trajtim të mbeturinave javore, ka ditore, brenda dites grumbullohen dhe dërgohen në Landovic. Mbeturinat brenda ditës nuk riciklohen por transferohen, grumbullohen me një pikë dhe së bashku transferohen. Llogaritne me ardhur prej Berishe prej Llapqeve me pak mbeturina me shku kamioni atje dhe ajo procedur kryhet , por kostoja e shpenzimeve rritet. Kompania i ka dy rrugë ose ka me falimentu ose ka me ngrit tarifen, e me ngrit tarifen keni me ngrit ju se është kompetencë me ligj që grumbullimi i mbeturinave është kompetencë e Kuvendit Komunal me caktu tarifat . Mementalisht amvisërit e kanë 4 euro e 50 cent që është masa më e madhe që krijon mbeturina. Sa i përket aspektit ligjor, na krejt e dime se në aspektin ligjor kjo nuk kalon. Plani kur është ba, ata që janë ka planer nuk e kanë paraparë një gjë të tillë me shti në plan. Venimin mujna me marrë në parim por me dhanë në shfrytëzim të përkohshëm, për me caktu pikë të transferit dhe pastaj me u konsultu me Ministrin që ata mos me na ba pengesa ligjore neve. Nuk është deponi, nuk kanë mu deponu mbeturinat, brenda dites grumbullohen në tërë territorin e Komunës së Malishevës dhe masdite eventualisht nesër në mengjes i transportojm. Kostoja e njësis tonë , kostoja e shpenzimeve më e madhja është te transporti , tek derivatet, tek defektet. I keni aty do kompaktor të mbyllur ,kjo kompani në Maqedoni që i prodhon këta , ingjinerët e tyre kanë qenë të gatshëm me ardh me shpjegu para jush se qka janë këta dhe sa e eliminojnë erën e keqe gjatë kompaktimit të mbeturinave . Ata inxhinier nëse ju mendoni me ba një dëgjim publik, ata inxhinier kemi mundësi me i thirr prej Maqedonie me ardhë këtu dhe me ju shpjeguar mënyrën se qysh kanë daluar ata prej situatë, sikur ne që e kemi.

Rrahim Morina: Urdhëro, Avdi e ke fjalën.

Avdi Morina: Faleminderit Kryesues! Meqenëse kjo temë është diskutuar disa herë nga anëtarët e Kuvendit Komunal, unë kam dashur të kërkojë që t'i kemi brenda sences edhe Drejtorin e Ekoregjionit në Malishevë edhe Drejtorin e Hidroregjionit në Malishevë, sepse janë dy kompani të cilaj kryejn shërbime për qytetarët . Këtu u diskutua sa i përket kosto, se në qoftëse bajm transfere rritet kosto. Ne duhet ta kemi një raport nga Ekoregjioni sa janë të hyrat te Ekoregjioni për Komunën e Malishevës, sa ka obligime kompania që kryen shërbime, shpenzimet t'i parasheh edhe atëherë t'i bajmë barazimet sepse ne nuk kemi një pasqyr të qartë qoftë te Ekoregjionit, por po ndëlidhem edhe te Hidroregjioni që më shumë krijon gropa nëpër qytet se sa na furnizon me ujë. Në një fare forme është dhe një jo menagjim i mirë, nga ana e personave përgjegjës në këto dy ndërmarrje publike. Duhet të gjendet një alternative e mirë , duke mos i bërë dëm as kompanisë, por duke i kryer shërbimet si është më së miri. Faleminderit Kryesues!

Muharrem Morina: Çështja e raportimit është e drejtë legjitime, mënyra e raportimit dallon. Menaxheri i njësisë nuk i raporton Kuvendit Komunal, i raporton Ekoregjionit. Në kuadër të Ekoregjionit Komuna e Malishevës merr pjesë me 5% të aksioneve. Raportin na ju sjellum komplet për Ekoregjionin jo vetëm

për njësinë tonë, sa marrum pjesë na me shpenzime dhe sa me të hyra.

Drejtorja e Shërbimeve Publike është përgjegjëse për me mbikqyrë pastërtin bashkë me Inspektoriatin, por me mbikqyrë kompanin është e rregulluar me ligj, është fjala për Ekoregjion. Ky kompaktor që e bënë kompaktimin e mbeturinave, pa e dëmtuar ambientin, duke e ulur aromën e keqe është ofertë e një kompanie që e ka bërë në Maqedoni . Investimin ka me kompania, jo Kuvendi Komunal.

Rrahim Morina: Fjalën e ka Valoni.

Valon Krasniqi: Grupi Parlamentar i LDK-së është që kjo kërkesë të miratohet , kurse obligative të jetë dëgjimi publik, për shkak që mos me na dal ndonjë konflikt me qytetarët. Është mirë me pas një takim ne grupet parlamentare dhe drejtorit përkatëse dhe të vazhdohet tutje.

Rrahim Morina: Urdhëro drejtor!

Milazim Morina: Ju faleminderit të gjithëve për kontributin që po e bëni rreth kësaj çështje. Hashim e përmende lokacionin pse aq ari, mu me duket që është ai lokacion kërkesa e tyre e vogël, kuptohet qdo kontinjer qdo prishje e tyre, qdo kamion duhet një vend i caktuar rregullimi i tyre. Desha me dha një mendim, me siguri përcaktohet një lokacion nga ana e Kuvendit Komunal, kushtet larg vendbanimeve, afër rrugës dhe të gjitha kushtet besoj se dhe Ministria ka me përkrah. Faleminderit!

Rrahim Morina: Urdhëro Alban!

Alban Krasniqi: Natyrisht qytetarët në plan të parë, natyrisht interesi publik sa më shumë me u marrë për bazë. Unë nuk e di pse nuk i kanë shikuar dhe disa alternativa, është ish airoporti bujqësor që ka qenë, nuk është pronë e privatizime.

Hashim Vrenezi: Ky lokacion që është në Bajë nuk është afër autostrades, është thuajse në krahun e djathtë të Bajes, përballë shkollës kryesore më ngat Kravasaries dhe siq po shihet këtu ka dhe gurdhies dhe ky lokacion nuk ka lidhje me autostraden. Nëse e marrum këtë vendim, ky person që është duke e shfrytëzuar kë të gurë thyes , mbi bazën e qfarë dokumentacioneve është duke e shfrytëzuar dhe a kemi të drejt me ja ndaluar këti shfrytëzimin? Ne nuk mujtum me pa sa është kjo hapsirë dhe cilën hapsirë me nda. Parcela totale është e kufizuar por nuk është e kufizuar hapsira prej 30 ari që e kanë kërkuar këta.

Rrahim Morina: Luan Kryeziu e ke fjalën.

Luan Kryeziu: Sa i përket pikës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/45 datë:16.01.2020, të parashtruar nga Kryetari i Komunës, sipas kërkesës nr.09/02-MB datë: 09.01.2019, për caktimin e lokacionit për vendosjen e pikës së transferit, për grumbullimin, transportimin, depozitimin e mbeturinave (jo të ngurta) të cilat grumbullohen nga K.R.M Ekoregjioni Sh.a në Prizren, njësia në Malishevë.Unë kisha mu ndal te kjo pikë e rendit të dites a është mirë me i define dhe me i caktu gjanat, se ne e dime një problem që e kena pas, me hapjen si asamble te qështja kishe me e rrit numrin e të punësuarve dhe aty na dul diqka tjetër .Nëse ne e përcaktojmë një lokacion për deponimin e këtyre mbeturinave, unë e kam friken këtu që është cek të ngurta dhe te cilësimi i mbeturinave mund të bëhet dallime kur të hudhen mbeturinat , duhet me ditë dhe qfarë mbeturina hudhen aty . Mos të devijohen gjanat nga ana e qeverisë Komunale.

Rrahim Morina: Alban Mazreku e ka fjalën.

Alban Mazreku: Pershendetje për të gjithë! Kryesues, mu personalisht nuk po më duket vendi qëllun të lagja Samadraxheve, për shak që këta po duhet me kalu nëpër shumë rrugë, ku ka shumë shtëpi dhe shumë banorë. Kishte me qenë mirë me mbajt një konsullt në nivel të shefave, së bashku me kompanin e Ekoregjionit dhe drejtorin e Inspeksionit dhe drejtorin e Shërbimeve Publike që mos të jetë gjithëqysh ky lokacion të lagja e Samadraxheve, është lokacion shumë i gravditun edhe prej nxënësve edhe prej banorëve, plus është dhe bazeni.

Banorët e kësaj lagje nuk kanë me leju huthjen e mbeturinave në këtë pjesë.

Rrahim Morina: Shefat e grupeve bashkë me drejtorin 10 minuta kanë konsult. Mos u vanoni më shumë se 10 minuta.

Rrahim Morina: Atëherë me që nuk kanë mundur me mrri konsensus shefat e grupeve, ne i kemi propozimet, kisha kërkuar që të deklarohen shefat e grupeve rreth tri propozimeve në Bajë, Drenoc dhe Dragobil.

Alban Krasniqi: Nëse ka diqka shkelje ma të ranë, shkelja ma e ranë është te gurthyesi aktual, i cili është duke vepruar në tokë publike dhe është lëshuar me leje të dyshimtë dhe unë po kërkoj a ka njerëz këtu që e kryejn detyren brenda drejtorive. A ka mundësi me na pru, kjo tokë te gurthyesi këtu a është në shfrytëzim dhe në bazë të cilit vendim është duke e shfrytëzuar aktualisht?

Për pjesën e Dragobilit, nuk jam hiq me shku atje, nëse ne po thojm me afri me Landovicen, as Dragobili as Drenoc nuk e sjellin atë përfitim të ndërmarrjes që ne po thojm. Gurthyesi kjo pjesa bishti që është 2 hektarë e gjysmë është vetëm kjo pjesa, janë tri-katër prona që janë prona private nëpër të cilat kalon rruga, ka nevojë dhe mu zgjeru rruga, hymë në bashkëbisedim me qytetarët zgjerohet rruga, 300 metra nuk i ka mu lidhë me rrugën që është Bajë-Bellanicë dhe 100 metra nuk e ka larg rrethin që të qon te autostrada. Bjerne vendimin ta shohim cilat janë kushtet, nëse vendimi vjen i pa bazë atëherë kemi me hyrë në dy procese edhe caktimit të saj por edhe një procesi gjyqësor, dikush le të jep përgjegjësi që paska dhënë një tokë publike në mënyrë të paligjshme. Le të na vin dokumentet për atë të Dragobilit, për të Malishevës, për të Bajes dhe dokumentet për Drenoc dhe le të na tregojn justifikimin, distancën sa larg është distanca e të gjithave me Landovicen. Unë jam për me shty, duke e parë se qka po tentohet të bëhet, t'i trajtojmë të gjitha qështjet ngadalë, me argument.

Rrahim Morina: Fjalën e ka Kastriot Berisha.

Kastriot Berisha: Pershendetje Kryesues, drejtor, kolegë asambleist dhe gjithë ju të pranishëm! Dy propozimet e sjellura, ajo e Dragobilit dhe e Drenocit grupi parlamentar i AAK-së është kundër këtyre dy parcelave, për arsye se kjo e Dragobilit veq është mbushur me shtëpi të banimit dhe fëmijët lëvizin andej me biçikleta dhe kjo në Drenoc sipas vizatimit që e kanë sjellur është afër rrugës kryesore. Për këto dy propozimet ne jemi kundër dhe votojm kundër.

Valon Krasniqi: Muharrem, a është e lejueshme tri propozimet veq e veq me u hedhë në votim dhe cili propozim i merr votat më shumë me mbet aty lokacioni.

Hashim Vrenezi: Unë jam për takime të hapura, nuk jam për takime të mbyllura. Çka të diskutojmë le të diskutojmë këtu dhe le të na dëgjon qytetari të gjithëve. Nëpër debate publike dhe nëpër qështje tjera qeverisja Begaj është duke u thirrur se asamble mua po ma pengon lokacionin e vendosjes së pikës së transferit dhe ne duhet me i tregu edhe qeverisjes Begaj edhe qytetarëve që na nuk jemi duke e penguar vendosjen e pikës së transferit, me zhvendos prej Malisheve dhe me vendos në një pikë tjetër.

Këtu shihet se qeverisja Begaj është e pa përgaditur dhe e pa edukuar për me sjellë lëndë të kompletuara, për me mujt me kalu lëndët. Ju lutem kolegë duhet me na sjellë lëndën me dëgjime publike të lokacioneve, ku dojnë këta me ba pikën e transferit, me marrë mendimin e qytetarëve, duhet me pru propozim të qartë sa ari kanë nevojë me i pas, duhet me i saktësu gjanat. Në qoftëse dikush ktu thotë që Drenovci është zone e mbrojtur, drejtori tjetër thotë që Dragobili është kontekst pronësor, nuk i kemi fajet ne asambleistat, fajet i ka qeverisja. Le ta qartëson kërkesën qeverisja, le ta bjen të qartë, të kompletune, le ta bjen me dëgjime publike, ne jemi për me përkrahë.

Rrahim Morina: Unë kam një propozim nëse ishi pajtuar dhe ju, ta shtyjme këtë pikë dhe ta debatojmë dhe një herë në Komitet për Politik dhe Financa dhe deri atëherë e gjejmë dhe ne një koncesues të gjitha subjektet politike në koridrim me ekzekutivin.

Kush është me shty këtë pikë të rendit të ditës për mbledhjen tjetër.

Kush është për me ngritje të dorës?

Për: 7

Kundër: 13

Apstenim: 3

Nuk shtyhet kjo pikë.

20 janë prezent. Atëherë shkojmë në votim për **lokacionin në Bajë**.

Kush është për?

Për: 1

Kundër: 13

Apstenim : 6

Nuk kalon lokacioni në Bajë.

Lokacioni në Drenoc, kush është për?

Për: 13

Kundër : 4

Apstenim: 3

Me 13 vota për, ndahet lokacioni për pikën e transferit të mbeturinave (jo të ngurta). Drejtoria për Shërbime Publike tash duhet t'i zhvillojë gjitha procedurat dhe ta bëjë dëgjimin publik.

Vazhdojmë në pikën tjetër: Shqyrtimi dhe miratimi i draft Rregullores për Tatimin mbi Pronën e Palujtshme për vitin 2021.

Kush është për?

Për: 18

Kundër: 0

Apstenim: 1

Kalojmë te pika tjetër: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/813 datë: 19.08.2020 të parashtruar nga Kryetari i Komunës, për ndarjen e lokacionit për ndërtimin e stadiumit ndihmës në Malishevë.

Fjalën e ka drejtori Rexhep Mazreku.

Rexhep Mazreku: I nderuar Kryesues, të nderuar asambleistë, të nderuar kolegë drejtor, zyra e Kryetarit dhe gjithë të pranishëm! Kërkesa për ndërtimin e fushës ndihmëse "Liman Gegaj" është bërë më herët, dikun me 16.07.2020. Ne si drejtori duke e parë interesimin e madh të qytetarëve, të fëmijëve, dhe të klubeve, e kemi pa të arsyeshme s'i nevoj dhe domosdoshmëri ndërtimin e fushës ndihmëse të stadiumit. Malisheva tani ka 5 klube të futbollit KF- Malisheva meshkujt me dy kategorit , klubin e

futbollit të femrave me dy kategorit senior dhe U-16, klubi i futbollit SHqiponja Drenoc me dy kategorit dhe klubin e futbollit Kjeva me një kategori, përafërsisht kanë 200 futbollist dhe futbolliste. Përveq klubeve kemi dhe shkollat e futbollit KF-Malisheva, Besa, Drenovci, Talenti, Kjeva, ku mendohet që dikun 700 deri 800 sportist që stërvitin në stadiumin “Liman Gegaj”.

Kryesues, kërkesa ju është drejtuar dhe juve si asamble dhe Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kataster.

Bashkarisht me Drejtorin për Gjeodezi kemi vizituar pikat edhe vendit, është prona publike që na lejon me pas fushën ndihmëse aty dhe janë bërë tri lokacione rreth stadiumit. Në bazë të kësaj kërkoj nga ju që të miratoni kërkesën për caktimin e lokacionit të fushës ndihmëse.

Për ndërtimin e fushës ndihmëse kemi bërë kërkesë dhe Ministries, me pas përkrahje dhe mbështetje. Ju faleminderit!

Rrahim Morina: Alban Krasniqi e ka fjalën.

Alban Krasniqi: Sa i përket fushës, kjo kërkesë e drejtorit gëzon mbështetje nga ana jonë, si Lëvizje Vetëvendosje dhe uroj që niveli qëndror t’i ndaj mjetet për realizimin sa më të shpejtë fushës së dytë sportive. Gjysma e Nismas jeni future në klub, në udhëheqje. Na i sjellni drejtor kush janë anëtarët, kush janë kryetarët e këtyre klubeve, si financohen këto klube që i përmende dhe sa paguhen ata lojtarë që luajnë aty, sa shkojnë paret që po i ndan Komuna për nevojat e lojtarëve dhe të klubit dhe sa shkon te menaxhmenti? A shkon për dreka e darka apo shkon për me ble pajisje dhe me ju mundësuar atyre sportisave me mbijetu disi. Na i sillni ato, pastaj diskutojmë.

Unë e përkrahi kërkesën për ndarjen e territorit të lokacionit për fushën e dytë, e mbështes iden që fusha të ndërtohet në pjesën e sipërme. Drejtor të inkurajoj që ta shikosh buxhetin e këti viti, e keni të ndarë mjetet për ndërtimin e shveshtores apo tribunes verilindore, punoni dhe realizoni buxhetin kështu e ndihmoni sportin.

Rrahim Morina: Sylë Dukolli e ka fjalën.

Sylë Dukolli: Faleminderit Kryesues! Edhe ne si Nismë jemi me përkrahë fushën ndihmëse. Faleminderit!

Rrahim Morina: Urdhëro Valon Krasniqi!

Valon Krasniqi: Të dashur kolegë, unë du mu ndal te disa statistika, pa stadium ndihmës KC-Malisheva ka korrur disa suksese. Klubi dhe djemt e qytetit tone pa stadium ndihmës e kanë mujt Istogin, Dukagjinin e Klinës dhe Vllazninimin e Gjakovës, tash llogaritne nëse ne e ndajmë edhe lokacionin për stadiumin ndihmës. Prej KC Malisheva kanë rrjedhur disa talenta siq janë: Ermal Krasniqi, Mendorim Hoti, Endrit Krasniqi, Edonis Krasniqin dhe shumë të tjerë.

Grupi Parlamentar i LDK-së përkrahë ndarjen e lokacionit, po ashtu përkrahë qdo kërkesë e cila vjen nga FC-Malisheva.

Rrahim Morina: Alban Mazreku e ka fjalën.

Alban Mazreku: Pershendetje për të gjithë! E falenderojmë Drejtorin e ri të Rinis Kulturës dhe Sportit për iniciativën për ndarjen e parces për fushën ndihmëse, ku këtë fushë do ta shfrytëzojnë të rinjtë e Komunës së Malishevës. Një sygjërim tjetër për drejtorin që ndarja e subvensioneve për shkollat e futbollit apo për KF- Malishevën, desha me ba një pyetje a raportojnë këta për shpenzimet e tyre dhe ku i bëjnë këto shpenzime? Grupi i Partis Demokratike e përkrah iniciativën dhe do të votojë për.

Rrahim Morina: Kush është për ndarjen e lokacionit për ndërtimin e stadiumit ndihmës në Malishevë?

Për: 23

Kundër: 0

Apstenim: 0

Me 23 vota për , asnjë kundër dhe asnjë apstenim votohet ndarja e lokacionit për stadiumin ndihmës. Kalojmë në pikën tjetër: Shqyrtimi i kërkesës nr.02/277 datë: 12.08.2020 të parashtruar nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, në lidhje me vendimin nr.02/05 datë: 10.01.2020 të Kuvendit të Komunës së Malishevës, për pezullimin e pëlqimeve për operimin e kompanive të gurëthyesve. Hapim debat rreth kësaj pike. Sylë Dukolli e ka fjalën.

Sylë Dukolli:Kryesues, është një pikë që është shtyrë qe shumë kohë, janë ardhur shumë letra, janë kthyer shumë përgjigje. Kur është marrur një vendim këtu në asamble për ndaljen apo heqjen e pëlqimeve për të gjithë edhe pararendësit e Kryetarit Begaj, jemi pajtuar që masovikisht të gjithë gurthyesve tu ndalet puna për arsye të dëmtimit të shëndetit të qytetarëve të Komunës sonë, realisht një gjë e tillë ishte e pa mujshme në realizim dhe atëherë ne e kemi ditur që ky vendim që po mirret nga asambleistët nuk është e drejt, sepse ne e dim që aty ku punohet ka dhe dëmtim. Malisheva si Komunë e varfër i vetmi biznes i ka këta operator, mjerisht që janë afër shëndetit tonë , por janë këta operator që gjenerojnë vende pune. Thjesht këtë na ka falur vet natyra.

Jemi kanë kundra pa ato përmasat që i përcakton komisioni për miniera dhe minerale, sepse aty ku dëmtohet shëndeti nuk ja vlejn edhe paret. Ju keni mbajtur takim me shefat e grupeve të asaj kohe nga komisioni i pavarur për Miniera dhe Minerale dhe në takim ju kanë thënë juve dhe Kryetarit Begaj se secila tërheqje nga Komuna, pasojat do ti bartë Malisheva, Komuna. Nuk jam për tërheqje selektive. Faleminderit!

Rrahim Morina: Alban Krasniqi e ka fjalën.

Alban Krasniqi: Ka ardhur një vendim prej një Ministrie, prej një Qeverie që partia e Komunës që qeveris këtu është bashkëqeverisje atje. Nisma, a e mbron interesin qytetar apo e mbron interesin e bizneseve me të cilat deri dje ka bashkpunuar dhe i ka pazaret bashkë.

A ka më krim që institucioni që është i marun me i shërby qytetarit, me nxerr vendime në interes të një biznesi , i cili nuk i ka respektu procedurën për me marr liqencen dhe nuk është i vetmi ai, është në Kravasari , në Astrazup. Punojsit aty e pranuan se ata funksionojnë në bazë joligjore aty, në afërsi është fjala. Aty punohet pa kushte, pa respektim të asnjë norme e standarti. Ne ishim dje dhe asnjë punojës aty nuk kishte helmet, as na që ishim aty nuk na u ofrua ndonjë helmet .

Kryetari Begaj është fajtori kryesor që sot dhe në të kaluarën prej 2014 kur ai zyrtarisht e ka marrur timonin e Malishevës në dorë për gati dy mandate, ai është fajtori kryesor sepse ka mundur me i parandalu nëse e kish pasur interesin qytetarë.

Gurëthyesi në Bajë nëse është duke punuar në mënyrë ilegale, nëse procesin e marrjes së lejeve e ka në mënyrë ilegale, ka shkelje ligjore, na po kërkojm që procesi mu pezullu deri sa të bëhet vlersimi i këtyre proceseve.

Andaj të bëhemi zëri i qytetarëve, t'i dalim krahë qytetarëve dhe mos t'i nënshtrohemi presionit dhe kajtes që dikush e ka, sepse në fund kemi me u kthi te ta, e ata na tregojnë vendin. Faleminderit!

Rrahim Morina: Faleminderit Alban!

Fillimisht ju pershendes të gjithëve! Unë po pajtohem që vendimi i Kuvendit mbetet në fuqi deri në kryerjen e procedurave, deri në sjelljen e një raporti të këti komisioni të pavarur që e ka punuar Komisioni për Miniera dhe Minerale dhe pajtohem që jo të shkohet në mënyrë selektive, është dashur të gjithëve tu tërheqet pëlqimi në mënyrë të barabart, sepse ekzekutivi në këtë rast ka kërkuar në mënyrë selektive, duhet me pasur guximin me vepruar për të gjithë në mënyrë të barabartë.

Qytetari ka bërë kërkesë me e formuar një komision, me shku me ja shikuar shtëpien që e ka të plasaritne dhe Kuvendi dhe ekzekutivi as që e ka formuar atë komision, shtëpit në Astrazup janë shumë të plasaritne dhe gjendja është shumë e mjerushme.

Nuk jemi kundër zhvillimit të Kuvendit, nuk jemi kundër zhvillimit të vendit, ne jemi kundër mënyrës së veprimit të gurëthyesve që nuk i zbatojnë të gjitha kriteret që duhet t'i zbatojnë. Ndoshta dhe vendimi i Kuvendit do të bërtet pasojat tjera, që kompanitë mund t'i bëjnë përdori Kuvendit Komunal për vendimin që e ka marrë, por edhe ne kemi fakte për vendimin që e kemi marrë, që ata nuk janë as përafërsisht duke i zbatuar kriteret që i kërkojnë gurëthyesit, prandaj është mirë ta mbrojmë qytetarin. Në këtë formë që janë duke punuar ata, unë jam që vendimi i Kuvendit të zbatohet në tërësi. Faleminderit!

Halil Morina: Kur e kemi marrur në këtë vendim në fillim të këtij viti, unë kam qenë kundër këtij vendimi, jo pse jam për me i leju me funksionu gurëthyesit, por kjo nuk është rruga e duhur për me ardhur deri te një rezultat që i zgjidhë problemet e qytetarëve, si pasojë e dëmit të këtyre gurëthyesve. Atëherë kam thënë kjo është një përpjekje me instrumentalizimi hallin e qytetarëve, për qëllime politike sesa për me zgjidh hallin. Atëherë kam thënë ne e marrim një vendim mirëpo ai vendim ska mu zbatu sepse MAPL-ja ka me na kthi kundër, na ka kthi prapë kundër dhe halli i qytetarit ka mbetur aty ku është. Andaj na sot mundemi me la në fuqi këtë vendim dhe mos me anulohet, por unë mendoj që kjo nuk është zgjidhje. Ne ishim dje me Inspektorët e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, mu më erdhi keq po ata veq inspektor nuk ishin, ata veq rrogë po merrshin për kurgja tjetër nuk ishin, sa për ata munden me ardh me hapë gurthyes të rrethi në Malishevë, sa po muqshin ata me thanë qka jeni tu ba. Atë vendim që e kemi marrur është përtej kompetencave tona, nuk është kompetencë e jona. Mua më intereson me funksionu me standart të njëjtë dhe me i trajtu krejtësisht njerëzit e jo në mënyrë selektive. Dëmi është shumë i madh plasaritja e shtëpive, ndotja e ajrit, prishja e rrugëve pra na i kemi shumë dëme e asnjë dobi.

Ne duhet me e formu një komision që duhet me u mirr me këtë punë legjislativë e ekzekutivë dhe me e zgjidh hallin e qytetarit pa qëllime politike.

Rrahim Morina: Urdhëro Behie!

Behie Sertolli: Faleminderit Kryesues! Unë nuk jam kundër bizneseve, mirëpo secili biznes, punësimet e ndryshme dhe vendimet duhet të plotësohen disa kriteret. Unë nuk po e kuptoj që pse Kuvendi nuk e ka obligim të merr vendime kur është në pyetje interesi i qytetarit. Nëse i kanë prurë ato biznese të operojnë këtu dhe nuk i kanë plotësuar kriteret, pse mos të marrin masa, nëse ekzekutivi nuk don, Kuvendi le të mbron interesat e qytetarëve. Nëse i ka plotësuar kriteret le të operon, por unë jam i sigurt që as ato si ka plotësuar. Inspektoriati asnjëherë në vend ngjarje nuk ka shkuar. I bëj thirrje Drejtorit të Inspektoriatit që ta dërgoj Inspektoriatin, njëkohësisht ka pasur thirrje dhe nga Kryetari i fshatit që nuk i kanë marrur parasysh kërkesat e tij që të dalin në vendngjarje. Faleminderit!

Rrahim Morina: Luan Kryeziu e ka fjalën.

Luan Kryeziu: Sa i përket Shqyrtimit të kërkesës nr.02/277 datë:12.08.2020 të parashtruar nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, në lidhje me vendimin nr.02/05 datë: 10.01.2020 të Kuvendit të Komunës së Malishevës, për pezullimin e pëlqimeve për operimin e kompanive të gurëthyesve pikë e cila është e përsëritur dhe e cila është shtyrë disa herë, sa i përket kësaj pike në diskutimin që e kemi pasur me 6 janar kam thënë që nëse mirret një vendim nga ana e asambles duhet të jetë vendim i barabart e jo vendim selektiv.

Drejtori i Urbanizmit mungon dhe pika e rendit të ditës është e tij. Te vendimi për qeshtjen e pezullimit të gurëthyesve është dashur që ndaj këtij vendimi të pritet edhe vendimi i MAPL-së, ku nuk është

respektuar dhe pse kë ta vetë kanë bërë kërkesë MAPL-së që ta shqyrton se a është ky vendim i ligjshëm apo jo i ligjshëm i asambles komunale, kur karshi kësaj kohe nuk e kanë pritur përgjigjen e MAPL-së dhe kanë marrur vendim selektiv dhe vendim për hakmarrje politike.

Drejtori na vjen nga fshati Astrazup dhe aty janë disa gurëthyes dhe hapi parë që është dashur me u ndërmarrë ka qenë aty ,sepse kanë qenë gurthyesit e parë që kanë vepruar në Komunën e Malishevës, pastaj i kemi gurëthyesin që operon në fshatin Kravasari, ku qytetarët e asaj pjese me protesta të ndryshme, me peticione të ndryshme dhe nuk është respektuar çështja e tyre sa u përket gurëthyesve në atë pjesë.

Në qoftëse vendimet e tilla zbatohen në mënyrë selektive dhe bëhet tejkalim i kompetencave të personit zyrtar duhet të ketë të qartë që është duke e shkelur kodin penal, ku e kemi nenin 414 që është keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, ku te paragrafi 1 thuhet Personi zyrtar i cili është duke e shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar, i tejkalom kompetencat e tij me qëllim që të fitoj qfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër, ose i shkakton dëmë personit tjetër dënohet me burg prej 1 viti deri në 8 vite burgim.

Drejtorit i referohem me pyetje se a kemi ndonjë investitor të huaj në Komunën e Malishevës?

Përderisa qeveria komunale merr vendime selektive , vendime hakmarrëse politike, atëherë është kjo pjesa që pse nuk kemi investitor të huaj dhe pse nuk kemi zhvillim në Komunën tonë.

Rrahim Morina: Këtë vendim që e ka quar MAPL-ja as nuk ka vulë, as nuk ka protokol dhe as nuk ka nënshkrim të Ministrit, prandaj kjo për mu është një letër e thjeshtë. Qdo vendim që e qojm na, ata janë të obliguar brenda 15 dite me na kthyer përndryshe vendimi hynë në fuqi nëse ata nuk na përgjigjen. Vendimi i Kuvendit është marrur me date 10.01.2020, sot jemi në muajin e 10, prandaj për mendimin timin ky nuk është valid dhe vendimi i Kuvendit duhet të mbetet në fuqi. Po i bëjë thirrje dhe drejtorit t'i tërheq gjitha vendimet në mënyrë të barabartë, jo në mënyrë selektive.

Alban Krasniqi: Shkresa që na është dërguar nga Ministria e Pushtetit Lokal nuk i përmban elementet e një shkrese zyrtare. Ministri i kualicionit këtu Goran Rakic nuk ka nënshkrim, nuk ka protokol. Ne sot mundemi me u pajtu, me i bërë thirrje Drejtorit të Urbanizmit që t'i tërheq pelqimet për të gjitha kompanit, qysh është vendimi i Kuvendit Komunal.

T'i ftojme organet e hetuesit që t'i hetojn të gjitha procedurat se si janë marrur këto licenca, të hetojnë mënyrën ku funksionojnë këta gurëthyes dhe s'i funksionojnë. Gurëthyesi i Kravasarit është as 200 metra pranë depozitës së ujit. Në Astrazup , në Bellanicë nuk ka dilem që është shkelur procedura dhe as dëgjim publik nuk është mbajtur.

Rrahim Morina: Valon Krasniqi e ka fjalën.

Valon Krasniqi: Sa i përket çështjes së gurëthyesve, Kuvendi kohë më parë e ka marrë një vendim që të pezullohen të gjithë gurëthyesit ose operatorët të cilët operojnë në Komunën e Malishevës. Këtu kemi diskutuar dhe cekur për gurëthyesit në fshatin Astrazup, në Bellanicë, Kravasari, Panorc, Turjak, gurëthyesin në fshatin Ngucat dhe fshatin Bardh nuk e kemi diskutuar asnjëherë. Sa i përket gurëthyesit në fshatin Bardh unë jam duke e hulumtuar rastin se kush qëndron pas këti gurëthyesit. Ne kërkojmë institucionet dhe qeverisja lokale por dhe nga kolegët e asambles komunale, që qdo vendim që merret për gurëthyesit ose operatorët që operojnë në Komunën e Malishevës të jetë për të gjithë gurëthyesit.

Kryesues kërkoj që dhe gurëthyesi në fshatin Bardh të hynë në mesin e këtyre gurëthyesve, që nëse u qesim kritere këtyre gurëthyesve t'i qitet kritere dhe gurëthyesit në Bardh.

Rrahim Morina: Valon, vendimi është për gjithë gurëthyesit në Komunën e Malishevës. Urdhëro Kastriot Berisha!

Kastriot Berisha: Pershendetje për të gjithë! Ne e kemi marrur një vendim, që jam pro ati vendimit për ndalimin e gjithë gurëthyesve pa dallim sei kujt është dhe kush është ky.

Unë në emër të AAK-së jemi pro këtij vendimi që ne e kemi bërë që të jenë të ndaluara të gjithë gurëthyesit në Komunën e Malishevës pa ba selektime . Unë e kam bërë një kërkesë dhe tash kërkojë prej juve që kjo që është ardhur prej MAPL-së dhe ai vendim që ne mos të bëjmë shkelje, që të hudhet sot në votim ose ka qenë mire që Kryetari të jetë prezent dhe të na tregoj që do të merr vendime për gjithë gurëthyesit në Komunën e Malishevës.

Na ja kemi mundësuar drejtorit, që drejtori me i pasur nën menaxhim dhe me lu me secilin gurëthyes në Komunën e Malishevës.

Rrahim Morina: Unë për mbledhjen e radhes kam me ju sjellë dhe e shqyrtojmë dhe e shfuqizojmë se 30 ditë ka afat, qdo vendim që kthehet ka MAPL-ja, Kuvendit I jepet kohë 30 ditë për shfuqizimin e tij. Urdhëro Fillorete Bytyçi!

Filloreta Bytyqi: Pershendetje për të gjithë të pranishmit në sallë ! Unë jam pro vendimit të Kuvendit që të pezullohen gjithë gurëthyesit, ashtu siq ka marrur vendim Kuvendi. Unë kisha propozuar që të formohet një trup i Kuvendit prej legjislativit dhe ekzekutivit që bashkë me inspektoriatin të jemi dhe ne aty prezent dhe ta shohim qdo shkelje ligjore. Unë jam edhe në Gjykat edhe në Prokurori për me imbrojtur interesat e qytetarëve tonë.

Alban Mazreku: Pershendetje për të gjithë! Po më duket që kjo legjislaturë ka filluar me gurëthyes dhe do me përfunduar me gurëthyesit debat dhe pa u marrur e pa u zbatuar asnjë rekomandim ose pelqim i asmbles komunale për këta gurëthyesit . Në vitin 2019 Drejtoria për Urbanizëm ka dhënë një leje ose një pelqim X kompanis për fillimin e procedurave për lejimin e gurëthyesit në territorin e Komunës së Malishevës, mirëpo me kalimin e kohës për arsye politike qohet i njejtë drejtor dhe e hek pelqimin. Ne e kemi më heret dhe një rekomandim për gurëthyesit që veprojnë në Komunën e Malishevës edhe këto rekomandime nuk besoj që është dalur dikush me i verifikuar.

Dje kemi qenë me Halilin dhe Alban Krasniqin dhe i kemi bërë disa vizita te gurëthyesit në fshatin Astrazup dhe fshatin Bajë, përfaqësuesit e LDK-së nuk morën pjesë në atë vizitë. Inspektorët nuk shprehen ndonjë paknaqësi aty, nuk thanë që janë në gjendje shumë të keqe gurëthyesit. Inspektorët e Ministries ishin Halil Halili dhe Rexhep Saliu.

Vendimet që I ka marrur Drejtoria e Urbanizmit mos të jenë selektive, ose të jenë për krejt gurëthyesit ose për asnjë. Faleminderit !

Rrahim Morina: Vazhdimi i séances të premtën me datë: 30.10.2020 ora 10:00. Faleminderit për pjesëmarrje!

Vazhdimi i mbledhjes së -VII-(shtatë) të rregulltë të Kuvendit të Komunës së Malishevës.

Mbledhja mbahet me date 30.10.2020 dhe filloi në ora 10:15. Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: 17 asambleistë, drejtorë komunalë dhe përfaqësues të mediave.

Rrahim Morina: 17 jemi prezent, vazhdojmë me pikat ku kemi mbetur. Kemi mbetur në pikën e 5. Shqyrtimi i Raportit të Drejtoris për Mbrojtje dhe Shpëtim për periudhën Janar- Qeshor për vitin 2020. Urdhëro drejtor e keni fjalën.

Hafir Rexha: Faleminderit Kryesues! Pershendetje kolegë drejtor, asambleistë, qytetar të Malishevës. Para vetes e keni raportin e Drejtoris për Mbrojtje dhe Shpëtim, të cilin e kemi dorzuar në kohën e parapar. Unë do të paraqes raportin e kësaj drejtorie. Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim dhe gjatë kësaj periudhe të cilën po raportojmë, i ka kryer detyrat e veta të parashtruara konformë ligjeve, rregullave dhe udhëzimeve që janë në fuqi në Republikën e Kosovës. Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim gjatë kësaj periudhe ka qenë bartëse e aktiviteteve në përgaditjen dhe emergjencave në territorin e Republikës së Malishevës dhe e cila ka menaxhuar dhe kordinuar me sektoret vartës dhe kryerjen e punëve dhe detyrave të parashtruara sipas Planeve të punëve për vitin 2020, në përputhshmëri me ligjet, udhëzimet administrative dhe rregulloret që janë në fuqi. Të gjithë sektorët e kësaj drejtorie e kanë kryer punën dhe detyrën e paraparë në kohë dhe me sukses. Gjatë kësaj periudhe drejtoria jonë sa i përket këtyre rasteve emergjente nuk ka pasur raste të humbjes së jetes së njerëz dhe as lëndime në njerëz. Sektori i planifikimit emergjent dhe gjatë kësaj periudhe ka vazhduar të jetë elementi themelor me identifikimin themelor të shkaktarëve të rrezikut, identifikimit dhe parandalimit të tyre, si dhe hartimin e planeve relevante, operative, emergjente. Sektorin ndaj zjarrit dhe hulumtimit në kuadër të drejtoris për mbrojtje dhe shpëtim gjatë 6 muajve të pare 2020 ka vazhduar të jetë element themelor për parandalimin e zjarrit në bazë të ligjit për mbrojtje nga zjarri me nr.04/L.012. Me kërkesë të pronarëve të objekteve të djegura apo të dëmtuara nga shpërthimi i zjarrit, janë lëshuar raporte nga sektori gjegjësisht. Në vazhdim janë të identifikuar inspektimet gjatë kësaj periudhe kohore. Inspektimet e rregullta i kemi 15, inspektimet kontrolluese 10, masat e propozuara i kemi 15, në sektorin privat 20. Njësia për zjarrfikëfikje dhe shpëtim, e cila është në kuadër të drejtoris tone, gjatë kësaj periudhe ka kryer detyrat sipas parashkrimit të vendit të punës. Në këtë raport ju paraqesum dhe kohën gjatë pandemic COVID-19. Me rastin e parë të paraqitur Covid-19 në Komunën e Malishevës me date:12.03.2020 në ora 22:00, me

vendim të Kryetarit të Komunës, sipas vendimit të Qeveris së Republikës së Kosovës, për aktivizimin e planit të reagimit kombëtar, aktivizohet edhe plani i reagimit për Komunën e Malishevës në kuadër të së cilës aktivizohet komiteti komunal për mbrojtjen dhe shpëtim dhe shtabi komunal emergjent për luftimin e pandemic COVID-19. Me komitetin për mbrojtje dhe shpëtim ka udhëhequr Kryetari i Komunës konform planit të reagimit dhe se i njeiti ka mbajtur gjithësej 4 takime, është fjala për periudhen për të cilën po raportojmë, ndërsa me shtabin Komunal emergjent ka udhëhequr drejtori i drejtoris për shëndetësi dhe mirqenie sociale. Në raport i keni edhe listat e donatorëve edhe implementimi i tyre qysh ka funksionuar. Shtabi emergjent implementimin e tyre e ka bërë përmes kryetarëve të fshatrave. Faleminderit!

Rrahim Morina: Hapim debat rreth kësaj pike. Kush e don fjalën? Urdhëro Ilaz e keni fjalën.

Ilaz Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Pyetja ime e parë është: Cilët janë operatorët, kamionët që i kanë zjarrëfiksat ?

Pyetja tjetër është: Tenderin për rregullimin ose mirëmbajtjen e këtyre automjeteve e ka marrur një mekanik që është nga fshati GurBardhë ose vllau i kryeplakut të fshatit, i cili nuk ka njohuri për këto makineri për t'i rregulluar. A e keni ndërmën me i pajisur zjarrëfiksat me një operator më të re sepse kamionët e tyre janë shumë të stërvjetruar?

Rrahim Morina: Hidajete Mazreku e ka fjalën.

Hidajete Mazreku: Pershendetje për të gjithë! Ne dëgjuam raportin për mbrojtje dhe shpëtim nga drejtori, mirëpo unë kam disa pyetje në lidhje me këtë raport, pasi që detyra kryesore e emergjences është parandalimi i fatkeqësive natyrore dhe teknologjike, s'i dhe zvogëlimi i rrezikut të tyre dhe gadishmëria për të ndërmarrë veprime të duhura në rast emergjente. Shtrohet pyetja: Sa është e gatshme Drejtoria për Mbrojtje në evitimin e rreziqeve të ndryshme që ndodhin në Komunën e Malishevës, sa mjete i ka dhe sa ka kapacitet njerëzor në evitimin e këtyre dëmeve që na bëhen në kohën e vërshimeve ?

Çka keni bërë, pasi keni marrur vesh për ramjen e qatis së ndërtesës kolektive Dardania, a keni krijuar ndonjë fond që ajo të riparohet?

Pyetja tjetër është: A keni ndonjë fond për dëmtimet në bujqësi sepse dhe unë kam aplikuar lidhur me dëmet që mu kanë bërë dhe kurrfarë përgjigje nuk kam marrë, dhe dëmet tjera të zjarrëfiksit?

Në raport ceket se nuk funksionin sektori i informimit dhe alarmimit, pse nuk funksionin, pse ne të presim nga Komunitet e tjera. Mbrojtja preventive nga zjarri, kam dëgjuar se nuk keni aq mjete për zjarrëfiksit, pse mos me ardhur kjo në Kuvend, me buxhet duhet të mbulohet kjo. Puntorët sezonal qysh regrutohen, a vetëm për sezona 3 mujore apo vetëm aty ktu atëhok.

Mjetet që janë ndar nga Kuvendi për Covid-19, ku kanë shkuar ato mjete?

Rrahim Morina: Fjalën e ka Nebi Bibaj.

Nebi Bibaj: Faleminderit Kryesues! Të nderuar kabinet qeveritar ju drejtor që jeni këtu, kolegë asambleistë, të dashur qytetar! Do ja nisi prej kësaj pjese të dëmtimit të kulmit, qatis të Dardanis, drejtor aty një ose dy javë kanë ndejtur llastrat në pjesën të muzeu. Për mua është shqetësuese kjo punë, që një Komunë mos me mujt me i hek dy javë ditë llastrat prej ati oborrit, dhe prej rrëzimit të asaj qatie nga të reshurat atmosferike i është dëmtuar banesa një djalit që banon aty. E keni kodin buxhetor për çështje emergjente, është duhur me shti në funksion dhe me i dal në ndihmë ati që i është dëmtuar banesa. Çështja të zjarrëfiksit është mirë që me i mbështetur, me ju dhanë paisje që ju takojn sepse jemi në rrezik prej zjarreve. A ka ndonjë raport, që arat që po digjen prej zjarreve, shumica e zjarreve po na vine prej asaj pjese dhe po dëmtohen edhe pyjet?

Drejtor është mirë me kërku një bashkëpunim me KEDS-in ose ndonjë formë presioni pozitiv, në atë aspektin që me i ndërruar përqesit elektrik ku janë të vjetër, sepse qdo herë kur ka erëra të mëdhaja, ka fshatra që mbesin pa energji elektrike.

Vërshimet drejtor janë të theksueshme, ndoshta qdo herë që bjen shi prej lagjes “Veselaj” në atë pjesën andej, qështja më e keqe e mundëshme që i ndodh një qyteti prej asaj pjese. Është ndonjë kanal atmosferik që duhet t’ja krijojmë atje dhe të rregullohet, po ashtu pjesa e Bajes. Faleminderit!

Rrahim Morina: Sylë Dukolli e ka fjalën.

Sylë Dukolli: Pershendetje drejtor, kolegë! Në qoftëse i referohemi periudhës së verës, rrezikohemi nga zjarret, nga ndeshjet e ndryshme të komunikacioneve dhe ajo periudhë më së tepërmi ka nevoj për pajisje të mira, mirëpo dhe tash jemi me një fazë që hiq më e lehtë nuk është sepse nuk kemi kurrfar infrastrukture që e hek borën ose e shkrin. Unë kërkoj nga dikastieret përkatëse që të kërkohen paisje dimërore për të cilat ndoshta drejtori na flet se nga furnizohi me pajisje dimërore apo i kryen operatori që është i zgjedhur në Komunën tonë. Sa trajnime i kanë kryer staf i operativ i cili merret direkt me rrezikshmëri apo në mbrojtje të qytetarëve? A bëni trajnime pa ndodhur rastet, për me ditë për sa minuta në secilin fshat të Komunës së Malishevës mund të mbërrini për me dhanë ndihmën?

Për çështje të uniformave, policia ka uniformë dhe kategoria e siguris ka uniformë, a keni mujt me ju siguru uniformen vjeshtore dhe a keni paisje për zhytjen në ujë? Sa i përket kohës së Covid-it, i falenderojmë gjithë ata donatorët që na janë gjetur afër dhe juve që përmes kryepileqëve të fshatrave ju keni dhënë ndihmë qytetarëve ato që kanë dhënë donatorët.

Në raport pash që nuk ka personel të mjaftueshëm, është mirë që të plotësohet personeli dhe të jetë i qertifuar për punët që kërkohen në këtë resor.

Rrahim Morina: Alban Krasniqi e keni fjalën.

Alban Krasniqi: Po du me u ndërlihdë te dy vërejtjet që janë përmendur nga Hidajeti dhe nga Ilaz Krasniqi. Ilazi e përmendi pjesën e servisimit të mirëmbajtjes së makineris, a keni guximn drejtor me ba hulumtim më të thellë se si ka rrjedhur ky tender t'i merrni gjithë ato dokumentet t'i shqyrtoni nëse kjo kompani, individ t'i ketë dokumentet në rregullë. Pjesë ku bëhet riparimi i kamionëve duhet ta kenë të veqantë. Po të ishi menaxhera qysh duhet jam i sigurt se dhe kamionët do t'ë ishin një pjesë e tyre në funksion . Qysh bjen përgjegjësia mbi ju dhe si i bëni procedurat, shpalljet e puntorëve sezonal, nuk është sukses se ti i angazhdon do puntorë, sukses është kur i ke marrë ma të mirët e mujshëm. Duhet me ba vlersimin e moshës mesatare të zjarrfiksëve, mbi 40 vjet është mosha mesatare, ne urgjentisht duhet të mendojmë ta rifreskojmë shërbimin dhe duke vendosur njerëz që i kanë përgaditjet e dhura dhe kjo përkthehet në përmirësim të shërbimit.

Sa i përket objektit Dardania, në mbledhjen e kaluar nuk e pranuat një kërkesë shumë të sinqertë, humane, që t'i dalum në ndihmë banorëve të kësaj lagje, që tua mundësojmë përmes fondit të Komunës, përmes vendimit të Komunës me ju rregulluar kulmin. Ju vetë e keni lanë në dorën e Komunës asambleistë të dashur. Ndërsa është detyrë e juaja fillestare drejtor qfardo gjëje, investimi, makinerie që përbën rrezik për qytetarët. Ju duhet me marrë masa për me gjetur zgjidhjet e tyre, ju duhet me na treguar që keni bërë sdi sa takime, e keni bërë presion e deri në ngritjen e padisë ndaj KEDS-it në për ata dhjetra bander, shtylla që rrezikojnë dhe sot jetën e qytetarëve, nëse nuk e keni bërë një gjë të tilli i bjen që nuk e keni kryer punën e juaj. Ajo qka mua më shqetëson është kjo pjesa e zjarreve, shkoni analizone rastin në fshatin Carrallukë, merrni gjitha shkresat, raportet prej policisë, kur është lajmëruar rasti, kur janë shkuar me intervenu dhe bane një analizë sa kilometra, kur a lajmëruar rasti, kur ka mbërritur dhe kur ka ndodhur fika e zjarrit, s'i ka qenë reagimi, a janë të përgaditur zjarrëfiksit taman për me fikë zjarrë?

Për fund dhe pjesa që lidhet me Urbanizmin, që lidhet me Inspektoriatin, ku ju duhet të jeni pjesë e krejt asaj ndërmarrjes ku lëshon lejet për ndërtim. Hidajeti e përmendi shkallët emergjente, ju e keni një ndërtesë të banimit social që nuk ka shkallë emergjente, ndonëse kanë qenë në projekt. Një ndërtesë duhet me i pasë dhe shkallë emergjente dhe daljen emergjente sepse rrejdhimisht je duke e rrezikuar jetën sepse ta ofron ndërtesen me ndërtesë dhe kur të ndizet zjarri nuk mundet me hy kamioni ndërmjet ndërtesave. Keni kujdes drejtor inspektora, ingjiniera të urbanizmit kur jepni leje. Faleminderit !

Rrahim Morina: Urdhëro drejtor e kni fjalën.

Hafir Rexha: Faleminderit Kryesues! Unë do përgjigjem radhazi te secila pyetje. Ilaz Krasniqi pyet Cila është aparatura e njësisë së zjarrëfiksave dhe e përmendi rastin në fshatin Carrallukë. I nderuar asambleistë, po jam në njohuri është e vërtetë që kamioni me të cilën ka filluar rugën për me ardhur me i kryer shërbimet në fshatin Carrallukë, ka qenë paksa i dëmtuar dhe pas evidentimit të këtij rasti ne bashkë me njësin e zjarrëfiksëve kemi reaguar dhe kamioni është rregulluar. Nuk është kompetenc e drejtoris sonë

me i kqyrë tenderimet se në qfarë kriteresh janë ba, neve na intereson që makineria me kanë në gjendje të rregulltë.

Profesoresha Hidajete thotë sa jeni jut ë gatshëm si drejtori për parandalimin e fatkeqësive natyrore? Profesoreshë Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim e ka planin e veprimt edhe vebfaqen e Komunës, ne veprojmë në bazë të ligjeve, rregulloreve që janë në Republikën e Kosovës. Qatia e kulmit të objektit kolektiv Dardania, në momentin e këti rasti ne si drejtori dhe njësia e zjarrëfiksave ka dalur në vendin e ngjarjes, i kanë kryer detyrat e veta që i kanë dhe kanë hartuar raportin dhe e kanë dërzuar te organi gjegjës që ka lidhshmëri në punët dhe detyrat që duhet me i kryer. Në kuadër të kësaj është e vërtet që kulmi ka mbetur para muzeut, ju kam ba thirrje përsonave përgjegjës që e kanë ndërtuar objektin, kanë ardhur përsonat përgjegjës, i kemi drejtuar te drejtoria përkatëse e shërbimeve publike dhe puna e njësisë tonë ka përfunduar me hekjen e tyre prej vendit, ajo kompani nuk menaxhohet prej Komune por ne i kemi kryer shërbim. Te sektori i alarmimit pergjigjjet me shkrim i keni në material. Profesoreshë e ke bërë një pyetje për Covid-19 ku the se Kuvendi ka ndarë mjete, ajo është periudhë tjetër kohore e raportimit dhe do ta keni në raportin tjetër 6 mujor. Faleminderit!

Rrahim Morina: Ju kisha lutur të jeni serioz të dy palët.

Rajmonda Krasniqi: Unë kërkova përgjegjësi prej drejtorit të emergjences dhe drejtorit të shërbimeve publike, sepse të dy drejtorët janë përgjegjës, është përgjegjës dhe drejtori i inspektoriatit. Pyeja ime ka qenë qfarë kanë ndërmarrë, a e kanë paditur? Nëse drejtorët thonë se është përgjegjësi e kompanisë e cila e ka ndërtuar kjo nuk është, është përgjegjësi e juaja. Marrëveshja është bërë prej ati privatit që e ka ndërtuar objektin dhe jush. Kush pergjigjjet për banesat e atyre banorëve që janë dëmtuar. Atë marrëveshje e ka një përson mirë po për momentin është në Gjermani, unë do ju sjellë atë kontratë.

Rrahim Morina: Urdhëro drejtor e keni fjalën.

Milazim Morina: Pershendetje Kryesues! Pershendetje për të gjithë! Deputete e nderuar e ndjej shqetësimin tëndë dhe të banorëve, unë jam munduar të sjelli para jush një dokument, mirëpo kishA mu ndi i kënaqur nëse kisha me gjetë atë marrëveshje që është bërë përmes kompanisë dhe banorëve.

Rrahim Morina: Drejtor, e ke pikën e rendit të ditës: Shqyrtimi i Raportit të Drejtorisë për Shërbime Publike për vitin 2020.

Milazim Morina: Faleminderit Kryesues! Detyrat dhe projektet e parapara nga kjo drejtori për periudhën janar qeshor 2020 në bazë të ligjit rregullores në Komunën tonë i kemi realizuar disa detyra disa punë që do t'i ceki: Shpallja dhe caktimi i linjave të transportit publik, mbikqyrja dhe ofrimi i shërbimeve publike dhe lokale, duke përfshirë furnizimin me ujë, rrjetin e kanalizimit, rrjetin e ujësjellësit. Me angazhimin si

drejtori bashkarishtë me shoqatat e dalura nga lufta dhe me disa qytetarë vullnetmirë, kemi punuar dhe te vorrezat e dëshmorëve, është i vendosur një lapidarë. Mbikqyrja e operatorëve ekonomik në bashkëpunim me policinë komunale për shërbimin e automarimanges , Mbjellja e luleve sezonale dhe drunjëve dekorativ në qytet, në varreza, mbikqyrja e shërbimeve që janë ofruar nga Bashkësia Islame të gjithë jeni të njoftuar dhe i dini këto. Është bërë mbikqyrja dhe përkujdesja e rasteve festive shtetërore, furnizimi i qytetit, i lapidareve, varrezave të dëshmorëve me flamuj kombëtarë dhe shtetëror.

Bashkëpunimi dhe kordinimi me KEDS-in, kemi bërë disa kërkesa sidomos nëpër fshatra, ku ka pasur nevojë dhe ato kërkesa janë të realizuara në disa fshatra. Kemi bashkëpunuar me kompanitë që ofron shërbime me furnizime të kyqjes të sistemit të ujësjellësit, kordinime me kompani sidomos me Hidroregjionin aty ku janë të bllokuara kanalizimet kemi pasur një bashkëpunim. Bashkëpunimi me Drejtorinë e Urbanizmit për hartimin realizimin në kuadër të veprimtarisë, ne si drejtori kemi pasur kërkesat tona për ndriqimin e fshatrave. Janë dhënë vendime dhe pëlqime për shfrytëzim të përkohshme për hapsira publike, për reklamim të aktiviteteve biznesore. Projekti i identifikimeve dhe verifikimi i deponive ilegale, këtë kërkesë e kemi sjellur që e ka bërë Komiteti për Financa. Kemi bërë menaxhimin kontrollimin dhe pastrimin e hapsirave publike, shesheve, varrezave të dëshmorëve, pastrimin e rrugëve të qytetit me ujë sipas marrëveshjes me kompani. Në kohën e pandemis është bërë dhe dezinfektimi i rrugëve që ka qenë jashtë kontrates që e kemi me këtë njësi. Mbikqyrja dhe transporti i nxënësve me kushte të rënda ekonomike për vitin shkollorë 2019-2020 bartja dhe pagesat janë bërë deri me 13.03 dhe me rastin e mbylljes së shkollave e kemi ndërprerë edhe atë marrëveshje. Faleminderit!

Rrahim Morina: Sdiqe Krasniqi e keni fjalën.

Sadiqe Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Kryesues desha të ndërlidhem me ju, me të vërtetë jeni një menaxhues shumë i dobët dhe po përdorni standarte të dyfishta, kur dikujt ja mohoni minutat ta merr fjalën e dikujt ja lejon me minuta sa të dëshiron vetë. Kryesues të lutem ta respektosh rregulloren e Kuvendit dhe mos përdor standarte të dyfishta.

Drejtor faleminderit për raportin unë kisha dy pyetje për ju: Drejtor e dimë që gjendja me kanalizime në Drenovc është shumë keq, qka keni bërë për Drenovc në mënyre të debllokohen këto kanalizime?

Pyetja tjetër është: Furnizim me ujë, keni bashkëpunim me kompani të ndryshme për furnizimin me ujë, e dimë në Drenovc nuk ka fare ujë dhe banorët janë duke u përballur me këtë vështërsi dhe nuk keni marrur asgjë në këtë drejtim?

Te drunjët dekorativ dhe me lule që bëhen në qytetin e Malishevës kisha dashur në këtë drejtim t'i jepet një pamje pak ma ndryshe se viteve tjera. Faleminderit!

Rrahim Morina:Faleminderit Sadije, të përgëzoj për atë këshillë që ma ke dhënë, do të mundohem ta respektoj, mirëpo po kërkoj që ju ta respektoni rregulloren e Kuvendit.Nëse jam menaxher i dobët kjo është vetëm sipas teje. Nebi Bibaj e ka fjalën.

Nebi Bibaj:Drejtor faleminderit për raportin! Drejtor viat e bardha i pashë që i kishi qitur mbrëmë, ato ishin transparente nuk ishin të bardha, po u dokshin s'i me u qitë para dy vjete e jo dje, kjo është jashtë qdo standarti. Tabelat nëpër hyrje të vendbanimeve kisha kërkuar drejtor qdo fshatit me ju qitë tabelen me ditë se cili fshatë është. Kisha një kërkes tjetër te shkollat me qenë viat e bardha dhe në të njejtën kohë me qenë dhe tabelat që tregon afërsinë që është afër shkollës. Drejtor mbeturinat në Komunën e Malishevës janë skandal, pak keni bërë në këtë drejtim edhe nëse keni bërë diqka keni pritur nga donatorët. Një ditë më parë kemi ndarë një lokacion, për mbeturinat jo të ngurta kisha pasur dëshirë drejtor që dhe ne si Kuvend të kishum mbështetur, me vendimin që do ta bëni një lokacion për mbeturinat e ngurta të cilat janë bërë shqetësuese për Komunën e Malishevës.

Drejtor dhe te kanalizimet ka një problem të thekumë në gjithë vendin, mirë është ku ka pjesë sidomos afër rrugëve, nëpër ara kur njëzrit tash kanë kohen me punu, sikur janë mbi sipërfaqe është mirë me i shti në sipërfaqe sepse i pengojnë qytetarët.

Trotuari në Senik që është duke u zhvilluar,qytetarët nëpër ato trotuare nuk kanë me mujt me ec sepse gjitha shpurat janë përmbi trotuar. Në shek. XXI shtylla elektrike midis trotuarit kjo është skandaloze, drejtor është mirë me bashkëpunu me KEDS-in me i hek ato shtylla. Faleminderit!

Rrahim Morina: Hashim Vrenezi e ka fjalën.

Hashim Vrenezi: Po e nisi te shyllat aty ku e la Nebihi, kërkesa për vazhdim të linjave të reja. Kam raste konkrete që jemi ballafaquar, ku e kam parë kanë ardhur zyrtarët e KEDS-it dhe i kanë vendosur shtyllat qysh ju ka marrë mendja atyre dhe ku ju ka ardhur më lehtë me ba gropimin e shtylles. KEDS-i paraprakisht ish dashtë me marrë pëlqimin në Komunë dhe cila është shenjëzimi i rrugës dhe ku është hapsira publike dhe hapsira që ata nuk e pengojnë rrugën. Kjo është shqetësuese dhe është dashur me penguar KEDS-in me kry këtë dukuri në këtë formë qysh është duke e kryer.

Te qështja e linjave të transportit të autobusëve, Drejtorja e Shërbimeve Publike është kompetente për ndarjen e tyre, qytetarët e Kjeves dhe Gjimnazi në Kjevë ka pasoja prej këtyre linjave, sepse nuk ka ndonjë linjë të autobusit i cili shkon në drejtim të Kjeves në orët e mengjesit.Besoj se pajtohi dhe ju si Kuvend të bëjmë një subvensionim të linjes së autobusit për atë kohë të përshtatshme, ose përgjysmë tja subvensionojmë atë linjë.

Çështja e mbeturinave është shumë shqetësuese, me këtë raport është dashur me na sjellur një plan, qysh me ju qasë qeverisja Begaj deponive të mbeturinave të ngurta dhe qfarë forme mundemi me zgjidhë këtë

problematikë.

Çështja e ujësjellësit ka ardhur një raport që thuhet që janë 19 fshatra ku është i shpërndarë ujësjellësi, është numri i konsumatorëve. Fshati Bajë furnizohen me ujë dhe disa fshatra të tjera, mirëpo lagjja Telakaj në Bajë nuk ka ujë dhe furnizohen me puse private. Fshati Dragobil është cek që ka ujësjellës dhe është cekur një numër i konsumatorëve mirë po aty nuk ka gati kurrë ujë. Fshati Shkozë janë një numër shumë i vogël i konsumatorëve dhe thuhet se nuk ka ujë gati kurrë. Në fshatin Astrazup thuhet se ka ujësjellës dhe në buxhetin e vitit të kaluar dhe për vitin që vjen jemi duke ndarë buxhet për këtë ujësjellës.

Çështjen e pastrimit të rrugëve është shqetësuese dhe duhet të analizohet. E cke hapsirat publike që i keni dhënë në shfrytëzim për reklamime të bizneseve, unë kisha dashur me ditë sa janë të hyrat të inkasuara nga kjo kategori buxhetore?

Çështja e kontrates me Ekoregjionin për pastrim edhe te kjo pjesë duhet të analizohet dhe të rritet numri i listës brenda kësaj kontrate, sepse ka dhe dukuri tjera që mundemi me futur brenda kësaj fushe, ka hapsira tjera që duhet me u mirëmbajt dhe me u pastru. Këtu mundemi me i futë dhe këto rrugët anësore me u pastrua prej këtyre shkurrave, ndoshta të pakten qdo dy vjet me ba një rregullore me i pastru. Dhe një pyetje tjetër: Si është bërë përzgjedhja e nxënësve që ju keni paguar transportin publik? Mirëmbajtja e parkut në Malishevë dhe Mirushë, parku në Mirushë duket sikur mos më u mirëmbajt fare, ndësa për parkun në Malishevë nuk kam ndonjë vërtetë për mirëmbajtje. Dhe lagja Lahaj dhe lagja Zymberaj sipas informacioneve të Nebihut kanë largësinë e duhur për tu përfshirë brenda organizimit të transportit publikë, pse janë diferencuar këto dy lagje. Ju faleminderit!

Rrahim Morina: Sylë Dukolli e ka fjalën.

Sylë Dukolli: Pershendetje Kryesues! Sadija i ngriti disa çështje, unë gjysë përgjigjje po ja japi. Sadije, këta krejt janë ba kundra neve, domëthënë i ka marrë votat qishtë me vepruar. Unë jam që 3 vite këtu nuk ka ndodhur me kaluar kohën. Ndërsa këto debate mes vete që nxiten, kërkojë një qetësi të dy anshme. KEDS-i është duke na bërë problem, i kemi bërë si lagje si fshat disa kërkesa me na hekur disa tela në lagjen tonë dhe kurrë nuk janë ardhur dhe kanë thënë nuk jemi përgjegjës. Për ujë skemi qe folum, prej Balinces, Llazices, Mleqanit, Kjeves na ujë kemi vetëm nëpër puse. Për miëmbajtje të kanalizimeve kërkoj që ajo njësia, ai operatori që i ka marrur për mirëmbajtje të jetë më i vëmendshëm dhe jo me shku 6 muaj dhe mos me na u përgjigjur.

Kërkesë kemi pasur nga një grup i mësimdhënësve që me u lëshu një linjë nga Malisheva në ora 7:00 me ju përgjigjur asaj pjese Drenovc, Lubizhd, Bubavec që shkojnë në drejtim të shkollës profesionale në Kjevë.

Te mbetjet e ngurta për këto betone, një depoti kështu është vetëm në fshatin tonë, na i thojmë Llukshiq

prej shkollës në drejtim të malit, jemi në gjendje dhe fshati bashkë vullnatarisht me ju bashkangjitë vetëm me na furnizuar me derivate dhe pak dhe vullnetare me pastruar atë pjesë të fshatit. Faleminderit!

Rrahim Morina: Alban Krasniqi e ka fjalën.

Alban Krasniqi: Është interesant një parafolëse që aktualisht po buzëqesh, dje e qojë doren dhe e votojë një zonë ku do të ndërtohet ajo pjesa e grumbullimit të mbeturinave dhe votojë pikërisht të vendin që është kyqur të fshati i saj dhe që sështë vendi i duhur aty dhe e vendosi interesin e partisë së saj, mbi interesin e vet dhe dy herë ka votuar tërsisht në kundërshtim me interesat e fshatit nga ajo i merr votat. Qytetari i Drenovcit po ja sheh sherrin një asambleiste, e cila nuk e mbron interesin atëherë kur duhet dhe del na moralizon neve kur me marrë fjalën dhe sa duhet me marrë fjalën. Ju jeni robë të Nismas. 47 kilometra është largësia prej vendit ku keni marrur vendim ju deri në Landovic dhe 35 kilometra është largësia prej vendit ku e kemi propozuar, i cili është dhe vend i degraduar. 45 kilometra është vendi prej Dragobilit, nuk i bëni këto analiza ju sepse ju ka verbruar disa interesa të tjera.

Sa i përket raportit, drejtori i ka sjellë informacionet që i kemi kërkuar dhe e falenderoj për sasinë e informacioneve që i ka sjellur. Kjo drejtori është lënë në mjerim qëllimshëm, për mos me mujt me i ba as objektivat, as punët që i ka si drejtori. Po filloj të qështja e transportit dhe linjave të transportit, këtu e keqja fillon prej momentit kur aplikojnë kompanitë, i marrin linjat dhe nuk i zbatojnë në praktikë këto linja. Drejtori duhet të na sillte sa linja egzistojnë në Komunën e Malishevës dhe sa realizohen ato linja në praktikë?

Furnizimi me ujë dhe mirëmbajtja e kanalizimeve, janë 19 fshatra në listen zyrtare që janë nën menaxhimin e kompanisë së ujës-jellësit. Ka qenë një projekt me kosto 1.2 milion zvicran dikur ka filluar në vitin 2016 sot jemi në 2020 dhe projekti ka qenë 3 vjeçar dhe projekti nuk është kërkuar, gypa keni futurë po ujë nuk ka.

Te kanalizimet është një kontratë mes Hidroregjionit dhe Komunës ku në bazë të kontrates ne paguajmë Hidroregjionin për secilin shërbim të riparimit, mirëmbajtjes së kanalizimit, në anën tjetër është e njejta kompani që na merr nga 1 euro në emër të kanalizimeve. Drejtor këtë kontratë me të rguar ne në Prokurori kjo bënë shkelje të rëndë, sepse ti je duke e paguar ekstra për shërbimin që ajo e ka obligim. Një tjetër qështje që duhet me pas parasysh është që kjo kompani, zyrtarët e saj duhet të përfshihen gjatë procesit të zbatimit të projekteve të kanalizimit dhe në momentin kur përfundon kanalizimi të nënshkrujnë dhe ata, që kanalizimi është kryer në gjendje të rregulltë dhe na e marrum përsipër mbikqyrjen e kanalizimeve.

Sa i përket ndriqimit dhe mirëmbajtjes së tij ka disa fshatra që është devijuar projekti i ndriqimi qëllimshëm dhe kam vërejtje për mirëmbajtjen e ndriqimit kostoja 40.000 drejtor rishikone, sepse nuk ka shance që mirëmbajtja e ndriqimit të jetë 40.000 euro. Te marrëveshja me Ekoregjionin 405.000 euro

është kontrata 2 vjeqare, 16.760 euro paguajm në muaj për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave. Ky llojë aktiviteti është vjedhje ashiqare e buxhetit, 889 euro i paguajnë në muaj për me i mbledhur mbeturinat te fusha e stadiumit të qytetit, për mirëmbajtjen e parkut të qytetit për qdo muaj i paguajmë 3336 euro.

Te KEDS-i inkurajojë drejtorë edhe ty edhe drejtorin e emergjencave të na bini një raport të detajuar mbi problemet që egzistojnë në rrjetin elektrik, cilat janë problemet që krijojnë rrezikshmëri për qytetarët dhe cilat janë nevojat për me i adresu, t'i ndajmë të dyad he ato që janë në rrezikshmëri të qytetarëve nëse ju nuk e keni guximin ne si Kuvend do e kemi guximin dhe do t'i adresojmë në organet e drejtësisë. Ju faleminderit!

Rrahim Morina: Sylë e ke një minutë replikë.

Sylë Dukolli: Unë nuk pajtohem me parafolësin që po na quan robë, nuk jamë robë i askujt. Qa ke ngritur qështje që kanë qenë në dobi të qytetarëve e ke pasur përkrahjen time dhe e ki, për anët tjera politike unë mendoj ndryshe, t'i ndryshe.

Rrahim Morina: Sadije një minutë e ke replikë.

Sadije Krasniqi: Unë këtu më tepër po shohë politikë dhe atë politikë për konsumë ditorë se sap o shikohet interesi i qytetarëve. Qytetarët na njohin secilin këtu, kush janë të angazhuarit kush janë përfituesit, kush janë matrapastit. Nuk ka nevojë askush me na dhënë epitete të ndryshme, ne kemi marrur vendime dhe robë të askujt nuk jemi, jemi përfaqësues të denjë të qytetarëve dhe jamë përfaqësuese e denjë e fshatit Drenovc dhe nuk e lejojë askujt të përzihet për fshatin Drenovc as ty nga Carralluka. Asnjëherë nuk do marrum vendimë të demshme për qytetarët. Faleminderit!

Rrahim Morina: Askujt nuk i mohohet e drejta me debate për qdo fshatë, sepse voten e merrë në tërë territorin e Komunës së Malishevës. Në ora 1:30 të kthehem, mos vanohi më shumë.

Rrahim Morina: Fjalën e ka Ilaz Krasniqi.

Ilaz Krasniqi: Faleminderit Kryesues! Drejtor dhe unë i kam dy pyetje për Ekoregjionin. A dezinfektohen ndonjëherë kontinjerët të cilët janë rreth objekteve publike sikur shkollat, në QKMF-në?

Te Hidroregjioni desha me ju pyet: A bëjnë analiza të ujit dhe a ju sjellin juve si Drejtori e Shërbimeve Publike se sa herë i bëjnë, a i bëjnë një herë në javë apo një herë në muaj analizat e ujit?

Dhe tek parku, është shumë e vërtetë që varrezat e dëshmorëve mirëmbahen shumë mirë, por tek sheshi i

dëshmorëve një vendim e ka nxerrur ky Kuvend për heqjen e billbordave, sepse aty po vendoset gjithëqka. Drejtor a jeni përafuar diqka me ba me këto billborda për heqjen e tyre?

Rrahim Morina: Faleminderit Ilaz! Fjalën e ka Arlindi.

Arlind Morina: Pershendetje kolegë asambleistë! Unë do të ndërlidhem me raportin, pyetja ime është se me ata konsumatorë që fakturohen për ujësjellës të cilët nuk e kanë rrjetin, qka do të bëhet? Në Astrazup kemi shumë familje që fakturohen dhe nuk janë të kyqur në ujë . Këtu thotë 102 konsumatorë i ka Astrazupi, sivjet ka filluar instalimi i rrjetit të ujësjellësit, i cili është është në mënyrë selektive. Faleminderit!

Halil Morina: Faleminderit Kryesues për fjalën! Faleminderit drejtor për raportin dhe për punën e angazhimin që e bënë në të mirë të qytetarëve të Komunës së Malishevës. Në qytetin e Malishevës i kam parë që kanë filluar sinjalizimi i rrugëve që është një lajm i mirë dhe ju përgëzoj juve dhe Drejtorisë së Urbanizmit në përmirsimin e rrugëve, ajo që është më e mira kur është prishur një rrugë është rregulluar për një kohë shumë të shkurtër. Ne si pyetje dhe si kërkesë është vizimi i rrugëve, qoftë i atyre lokale apo maxhistrale. Drejtor kisha kërkuar prej teje me ba kërkesë na në Ministrinë e Infrastruktura ose me mjete tona këtu me ba vizimin e rrugëve.

Kjo pikë u përdorë edhe për fjalime politike, fjalime fyese, këtu thoni se ju jeni robër të njerëzve, ju jeni mashtrues, kur doni debatojmë kush robë i kujna është dhe cila parti politike është ndërtuar mbi mashtrimin.

Rrahim Morina: Ju kisha lutur të jeni të përmbajtur në diskutime.

Në një trajnim që kemi qenë ne në mesin e shumë anëtarëve të Kuvendit kam qenë edhe unë dhe njerëzit që kanë qenë profesionalistë në këtë punë, na kanë thënë se për mirëmbajtjen e kanalizimeve është Hidroregjioni dhe Komuna nuk e ka përsipër përgjegjësinë me mirëmbajtje kanalizimet. Nuk kemi nevojë ne të ndajmë mjete nga buxheti i Komunës për mirëmbajtjen e kanalizimeve.

Çështja tjetër që për mua është mjaftë shqetësuese Halili kalon nëpër atë rrugë që tha nuk ka gropa, unë du me i treguar Halilit që Hidroregjioni ka shkuar e ka gropuar aty dhe ashtu e ka lënë gropen dhe nuk është marrur me këtë qështje.

Është shqetësuese devijimi i projekteve sidomos të ndriqimit, që tek ne në fshatin Astrazup ka ndodhur. Drejtori i Urbanizmit trupat ndriques që kanë qenë me u vendorus në rrugën “Shpëtim Robaj” dhe në rrugën “ Ismet Robaj” i ka qar në rrugën “Abdyl Frashëri” që është rruga e tij ku jeton ai. Unë kam qenë dhe te Kryetari dhe kam biseduar, unë do ti drejtohem dhe me shkrim s’i Kryesues i Kuvendit për gjitha projektet që janë duke u devijuar nga drejtoria e Urbanizmit . Faleminderit!

Milazim Morina: I mora disa pyetje: Sadije te bllokimi i kanalizimeve në fshatin Drenovc kanë filluar me u kryer, mirëpo janë disa punë aty që nuk mujnë me u kryer pa u hapë kanalizim i ri, diku 800 metra është I bllokuar kanalizimi. Nebi Bibaj rregullimi i vijave :është ende duku u punuar, vendosja e tabelave në fshatra është kërkesë me vend dhe e pranojë këtë kërkesë. Mbeturinat e ngurta: Nebi është shqetësim për mbeturinat e ngurta, në qeverisjen e më hershme është një vendim qe e kanë marrur një lokacion që e kanë caktuar në Panorc por ende nuk është zbatuar. Te KEDS-i kemi vështërsi te shtyllat elektrike sepse nuk po i kryen punët të cilat ne po i kërkojmë.

Hashim kërkes për nxënës është kërkesë me vend, ne kemi bërë një kërkesë prej fshatit Llozicë, Vërmicë, Drenovc që autobusi të shkojë në Kjevë, miëpo nuk kemi gjetur kompani e cila ju ka përgjigjur kërkesës tonë.Mrëpo tash do ta bëjmë një kërkesë Malishevë-Kjev ndoshta do gjejmë një kompani që do i përgjigjet kërkesës sonë. Pikat ilegale, kanë qenë zyrtarët e Komunës, të Inspektoriatit, komision që i ka caktuar këto pika, kanë qenë dy komisionerë të Komunës tonë dhe kanë bërë regjistrimin e pikave ilegale të vendit të mbeturinave. Për transportin e nxënësve vitit te kalumë, të gjithë nxënësit kanë qenë me asistenc sociale dhe kemi pasur numrin e caktuar dhe kemi bërë përzgjedhjen e tyre. Rregullimi i kanalizimeve, unë ju kam dëshmuar punët të cilat i ka kryer Hidroregjioni, në disa vende nuk kanë mundur mu kryer sepses ka pasur mjete. Ju faleminderit

Rrahim Morina: Atëherë kalojmë në pikën tjetër: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.06/89 datë: 01.09.2020 të parashtruar nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Shërbim Pronësoro-Juridik në lidhje me rregullimin e parcelave brenda oborreve të shkollave. Urdhëro drejtor e keni fjalën.

Bashkim Krasniqi: Faleminderit Kryesues! Të nderuar kolegë drejtor, ju asambleistë dhe gjithë ju që jeni të pranishëm këtu. Nga drejtoria jonë është paraqit një kërkesë për shqyrtim dhe aprovim nga ana e Kuvendit Komunal, e cila ka të bëjë me rregullimin e parcelave në hapsirat ku është oborri I shkollave fillore të cilat I kemi paraqitur në kërkesë. Janë 8 shkolla për të cilat është paraqitur kërkesa, kryesisht jemi shkuar tea to shkolla që janë të ndërtuara në prona publike dhe qëllimi është me ba një përkufizim të oborrit të shkollës dhe ai oborr të jetë I ruajtur dhe në të ardhmen. Është bërë ingjizimi andej ka i kanë rrethojat shkollat dhe brenda oborrit të shkolles në Bellanicë janë gjelbrim. Kështu kemi vazhduar dhe me shkollën e Damanekut, dy shkollat në Drenovc, dy shkolla në Bajë, Bubavec dhe Carralluk. Qëllimi është ndarja e këtyre parcelave, pronësia të jetë Kuvendi Komunal, shfrytëzimi aktul është pjesa tjetër që mujm me punu në katastër me plotësim të dhënave. Shkruhet shërbime publik shkolla fillore përshembull emir i shkollës për cilën është fjala. Faleminderit!

Rrahim Morina: Faleminderit drejtor, është iniciativë e mirë. Unë kisha kërkuar që debate të jetë në nivel të shefave të grupeve. Sylë Dukolli e ka fjalën.

Sylë Dukolli: Unë kam një pyetje: A ka pronë private në kuadër të këtyre, a kemi me ba ndonjë kompenzim na? Ne e votojmë.

Rrahim Morina: Hashim, urdhëroni.

Hashim Vrenezi: Drejtor, faleminderit për raportin që e ke sjellur për një punë të mirë. Ajo qka po më intereson, a ka edhe shkolla tjera në Komunën tonë që duhet me u intervenuar në këtë formë, apo janë vetëm këto shkolla? A është bërë një ingjizim i gjitha shkollave në nivel Komunal, apo keni marrur një iniciativë si pilot-projekt këto shkolla dhe mandej keni me vazhuar dhe me të tjerat ?

Sipas informatave ka dhe shkolla të ndërtuara nëpër prona private dhe a keni menduar se në qfarë forme me i zgjedh këto probleme? Pyetja tjetër hapsirat që kanë me mbetur brenda shkollave, ndoshta nuk është mirë me ja leju shkolles nëse nuk është e nevojshme për kërkesat e shkolles, ajo mundet me mbet pronë publike afër shkolles por nuk do të thotë me përkufizë dhe me futur brenda oborrit të shkollës në qoftëse nuk I nevojitet shkolles. Ne e përkrahim këtë iniciativ. Faleminderit!

Rrahim Morina: Valon e ke fjalën.

Valon Krasniqi: Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrahë këtë kërkesë.

Rrahim Morina: Alban Krasniqi e ke fjalën.

Alban Krasniqi: Dhe ne e mbështesim këtë kërkesë. Unë jam që sa më shumë hapsira publike të futet brenda shkollave sepse fëmijët përveq fushes kanë nevoj dhe oborr me pas për me nejt.

Rrahim Morina: Luan Kryeziu e ka fjalën.

Luan Kryeziu: Sa I përket kërkeses së parashtruar nga ana e drejtorit dhe ne si grup i Aleances e mbështesim. Faleminderit!

Rrahim Morina: Nebi Bibaj e ka fjalën.

Nebi Bibaj: Drejtor faleminderit për këtë iniciativë të mirë, këto kërkesa që I ke pru. Janë disa shkolla që e kanë një problem, shkolla te ne në Lladrovë është komplet shkolla pronë private, në atë kohë është bërë këmbimi i pronës gjëja që në pronë publike, por edhe ajo pronë që ju ka dhënë atje ka shumë mundësi që mos është e privatizume. Në shkollën tonë janë diku 4 parcela që janë në pronë private, si do ta zgjidhni këtë problem? Faleminderit!

Rrahim Morina: Edhe në Bardhë është e njejta, por këta e rregullojnë atë qështje. Urdhëro, drejtor!

Bashkim Krasniqi: Sa i përket pyetjeve që ju i paraqitët, nuk ka nevojë për kompenzim për këto shkolla që tash janë në kërkesë, janë prona publike, vetëm kërkohet një rregullim i saktë i tyre definim i pronës që mos me u cenu ajo pronë. Do vazhdojmë dhe me shkolla tjera, kryesisht e kemi bërë një selektim, qka janë prona private i kemi ndarë veq sepse duhet një zgjedhje tjetër. Çështja tjetër që janë që janë shkollat në prona private, shkolla në Lladrovë është e ndërtuar në pronë private sipas asaj që e kam informacion është bërë një lloj këmbimi i pronave por që nuk është shkuar deri në fund, nuk është zyrtarizuar ai këmbim. Ne e bëjmë një analizë nga kush është bërë prona dhe nëse kem mundësi me bad he kujt ju ka kompenzuar ajo pronë dhe pastaj me prunë në Kuvend dhe me fillu procedure e këmbimit. Faleminderit!

Rrahim Morina: Përgadituni për votim për kërkesë :Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.06/89 datë: 01.09.2020 të parashtruar nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Shërbim Pronësor-Juridik në lidhje me rregullimin e parcelave brenda oborreve të shkollave. Kush është për me ngritje të dorës?

Për:19

Kundër: 0

Apstenim: 0

Kalojmë në pikën tjetër: Shqyrtimi dhe miratimi i draft-Rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e të drejtave të Fëmijëve. Shkojmë në nivel të shefave.

Sylë Dukolli: Ne e votojmë këtë projekt-Rregullore për përkujdesjen dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Rrahim Morina: Urdhëro Nebih.

Nebih Bibaj: Ne jemi për me i dhënë driten e gjelbërt me shku në dëgjim publik, por e kam një kërkesë kjo rregullore ndoshta ka pak të fëmijët me nevoja të veqanta, është mirë me u zgjeru në këtë pjesë dhe pjesën e dytë që këtyre fëmijëve tu garantohet për ndihmë juridike falas në zyren që e kemi në Malishevë. Faleminderit!

Rrahim Morina: Valon e keni fjalën.

Valon Krasniqi: Grupi parlamentar i LDK-së voton pro miratimit të draftë-Rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe i japim driten e gjelbërt për dëgjim publik.

Rrahim Morina: Fjalën e ka Alban Krasniqi.

Alban Krasniqi: Urojë që kjo rregullore mos ta ketë fatin e shumë rregulloreve dhe ligjeve të ngjajshëm, që vetëm i aprovojmë për me ba një plus tek raporti i progresit. Nëse shikohet brenda kësaj draft-rregullore I keni të drejtat parimet kryesore, roli i Komunës dhe mekanizmat e Komunës. Në momentin që ne e aprovojmë këtë rregullore në leximin e dytë, i jepë përgjegjësi dhe obligime nivelit lokal prej Kryetarit deri tek qendra për punë sociale, tek drejtorit përkatëse që unë nuk pajtohem që të jetë drejtoria për kulturë dhe sporte. Këtu kemi të bëjmë me të drejtat e fëmijëve, mundet eventualisht zyrtarja për barazi gjinore që e ka dhe segmentin e të drejtave të njeriut, të jetë bartësja, raportuesja kryesore e zbatimit të kësaj rregullore, s'i dhe plani i veprimit për zbatimin e kësaj rregullore është I parapamë, pra të merren hapat konkret . Në momentin kur të vjen në lexim të dytë do duhet të na paraqiteshin përgjigjet me shkrim për këta hapa që ne thamë që është dashur të ndërmerren. Mbas Kryetarit Begaj ta dimë saktë kush është autoriteti tjetër që bëhet përgjegjës për kordinimin e zbatimit të kësaj rregullore. Faleminderit!

Rrahim Morina: Fjalën e ka Luani.

Luan Kryeziu: Sa përket draftë-rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, është e mirëseardhur, për arsye se mbrohet shtresa që është më e dobët e shoqërisë dhe që kërkohet një përkujdesje e veçantë ndaj tyre. Te qështja e qëllimit, ka mundur me u përkufizuar pak më shkurtimisht dhe mos me u ndarë shumë me paragrafe sa i përket qëllimit të kësaj rregullore. Tek faqja 5 këtu po del me të meta, nuk del e radhitur mirë. Parimet e përkujdesjes dhe mbrojtjes së fëmijës kapitull 2, kapitull 3 përkujdesja dhe mbrojtja e fëmijës, ka mundur me u nxjerr një term tjetër për me dalë pak ma mirë kjo rregullore. S'i draftë rregullore ne e mbështesim dhe jemi për me dërguar në dëgjim publik.

Hidajete Mazreku: Rregullorja për të drejtat e fëmijëve ish duhur më herët të përpilohet, jemi me vonesë për të drejtat e fëmijëve. Unë sa e pashë ka shumë ngatërime nëpër nene, neni 3.1 familjeve me nevojë të veçantë, a është prindër apo është fëmijë, të dertiminohet neni kur paraqitet duhet me u thirrur ne në atë nen. Zyrtarja për barazi gjinore është dhe për të drejtat e njeriut, duhet patjetër me u adresuar te kush të lypet përgjegjësi për këtë draftë-rregullore ose a respektohen të drejtat e fëmijëve. Te krijimi i asambles të fëmijëve, ku do të përfshihen dhe prindërit dhe nxënësit, ku fëmijëve do tu mundësohet një shancë që në të ardhmen të ketë mundësinë të ketë përvojë për asamble. Këto nene duhet me u korrigjuar dhe jemi pak më të qartë. Tek integrimi i fëmijëve me nevoja të veqanta paraplegjikë, tjetra plegjikë, hale na nuk e pashë këtu që e kemi të përfshime dhe si do të përkujdesen.

Rrahim Morina: Le të autorizohet zyra për barazi gjinore, DKA-ja dhe Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport ta organizojë dëgjimin public të kësaj rregullore. Kush është për, që ta hedhim në dëgjim publik rregulloren për përkujdesje dhe mbrojtje të drejtave të fëmijëve.

Për: 19

Kundër: 0

Apstenim: 0

Kalojmë te pika tjetër: Shqyrtimi i kërkesës nr.02/255 datë:16.07.2020 të parashtruar nga shefi i grupit të anëtarëve të Kuvendit të Komunës nga radhët e AAK-së, për pjesëmarrje në Komitetet e përkohshme të formuara nga Kuvendi i Komunës në Malishevë. Luan para se me ta dhënë fjalën dua me lexu udhëzimin administrative. Udhëzimi administrativ është numër 02/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrative të MAPL-së nr.03/2014 për procedure e themelimit dhe përbërjen e kompetencave të komiteteve të përhershme në Komunën e Malishevës. A shkojmë te përbërja se pjesë tjera janë të pa nevojshme. Neni 10 B thotë përbërja dhe organizimi i komiteteve të tjera që themelohen nga Kuvendi i Komunës, në fushat e caktuara të përbërë nga anëtarë të Kuvendit dhe përfaqësuesit jashtë Kuvendit të Komunës. 2. Kuvendi i Komunës mund të merr vendim për emërimin e anëtarëve të komitetit dhe përfaqësuesve jashtë Kuvendit me kushtë që shumica e anëtarëve të komitetit të jetë në përbërje të Kuvendit, anëtarët e jashtëm nuk kanë të drejtë vote. 3. Këto komitete duhet të reflektojnë në përbërjen e Kuvendit të Komunës. 4. Numri i anëtarëve në një komitet duhet të jetë maksimal 5. Kompenzimi është i njëjtë me anëtarët e tjerë të komiteteve të përhershme, anëtarët e komiteteve mund të paguhet deri në 6 mbledhje dhe më shumë nuk paguhet. Luan e keni fjalën.

Luan Kryeziu: Ne jemi për me shty këtë pikë të rendit të dites sepse dhe propozuesi i kërkesës nuk është i pranishëm dhe e lajmë për një mbledhje tjetër. Faleminderit!

Alban Krasniqi: A është Aleanca grupë Parlamentar, në bazë të praktikës është. Mbledhet KPF-ja e diskuton formatin si e ka, i trajton kërkesat që i kanë të dy grupet dhe në fund vjen me një zgjidhje të përbashkët për përbërjen e komiteteve dhe komisioneve dhe qfardo strukture jashtë Kuvendit. Unë nuk jam që të votohet veq për Aleancen veq për Nismen, por i mbledhin kërkesat e tyre i adresojnë, nuk mujm me marrë vendim ne prap. Ju një send dine nuk mundeni me pas në një numër ku është 5 anëtarë nuk mundet mi pas 2, si ai 1 që është si ti që është 10 kanë më pasur 1. Realisht në KPF dy vende ju takojnë juve, nga një na takon neve tjerë, sepse formati është i tillë, të kishte me qenë një më shumë që pranohet në KPF ai i radhes i kish takuar PDK-së.

Halil Morina: Kur i kemi formuar këto komitete të përkohshme, i kemi themelur dhe i kemi ndarë anëtarët dhe ja keni lanë dy të rezervuar NISMA-s, ne atëherë sjemi pajtuar me atë skenë dhe kemi menduar që është gabim dhe skemi marrur pjesë . Ne tash i kemi dy vende që janë të rezervuar për ne dhe e kemi bërë një kërkesë me plotësuar këtë numër. Është themeluar një grup i ri për me marrë pjesë dhe Aleanca në këto komisione, ne tash duhet me ba një strukturim total të këtyre komiteteve të përkohshme. Këto dy vende tona duhet me u plotësuar sot sepse e kemi bërë kërkesen.

Alban Krasniqi: Rregullorja, udhëzimi administrative që ju referu Kryesuesi ka dalur në vitin 2018, kur ne ju kemi ndarë dy pozita juve, për mua argument përbën udhëzimi administrative që ka dalë më vonë , ne me udhëzim administrative të vjetër kemi punuar .Udhëzimi i ri ka thënë: nëse 5 veta, nëse 5 anëtarë duhet me qenë, ka një duhet me qenë nga secila parti. Unë po propozoj Kryesues ta hedhësh në votim.

Rrahim Morina: Valon e keni fjalën.

Valon Krasniqi: Unë desha me u ndërlidhë me rregulloren, ku thotë që anëtarët që i binë subjektet politike që nuk janë pjesë e Kuvendit nuk kanë të drejtë vote, është mirë me kritikuar veten sepse paskemi bërë shkelje ligjore. Unë mendoj që ka komisione që anëtarët sjanë pjesë të Kuvendit që sigurisht ata kanë votuar dhe kanë sjellë diqka këtu, e na e kemi qar përpara.

Rrahim Morina: Kush është për që Aleances ti mbetet nga një vend në komitete dhe emrat t'i bjen në mbledhjen tjetër?

Për:14

Kundër:0

Apstenim:7 . Me 14 vota për Aleances i mbetet nga një vend që mbledhjen tjetër ti sjellë emrat.

Atëherë kalojmë piken tjetër në pikën e Nismes. Shqyrtimi i kërkesës nr.02/256 datë: 17.07.2020 të parashtruar nga shefi i grupit të asamblistëve nga radhët e Nismës Socialdemokrate në Malishevë, lidhur me plotësimin e Komiteteve të përkohshme të formuara nga Kuvendi i Komunës . Urdhëro Sylë!

Sylë Dukolli: Kryesues unë e kam sjellë një listë moti me të gjithë dhe me ato komisionet e përhershme. Unë du me i qit në votim asambleistat që i ka propozuar NISMA bashkë me ne për komitetet jo përhershme. Komiteti për planifikim urban, kataster, mbrojtje të mjedisit, turizëm, mbrojtje të projekteve: Avdi Morina, Faik Zogaj. Komiteti për diasporë: Abetare Limaj, Astrit Sertolli. Komiteti për

bujqësi dhe zhvillim rural: Donjetë Shijaku, Demir Bajra. Komiteti për arsim, kulturë, rinë dhe sport: Valon Sertolli, Halil Morina. Komiteti për shëndetësi, mirëqenie sociale dhe përsona me nevojë të veqanta: Aziz Thaqi, Genc Shurdhaji. Komiteti për familje të dëshmorëve, invalidë, veteran të luftës: Sylë Dukolli, Shqipron Berisha.

Rrahim Morina: Fjalën e ka Valoni.

Valon Krasniqi: Kryesues LDK-ja ka kërkuar qysh moti që një anëtarë të zëvendësohet në komitetin e bujqësisë. Diqka qka është shqetësuese është pasiviteti i këtyre komisioneve, përshembull a kemi drejt ne me i monitoruar, me kqyrë sa janë tu thirr mbledhje e sa jo. Ka komitet që nuk kanë mbajtur mbledhje që 3-4 muaj. Përgjegjësi e kujtë është, sepse dhe vlera ju hupë atyre komiteteve.

Alban Krasniqi: Sikur të kishte ndarje të barabart, sikur po e ndajmë këtu, institucionet në Komunën e Malishevës do të frymonin shumë më shpesh, do të ishin më me integritet dhe nuk ishin të ngulfatura nga militantët të Nismas. Pse e merr shumicën e jeni 10 vota mendoni që mundeni me ba qka të doni, por nuk mundeni sepse demokracia nuk shkon kështu. Po ja kërkoj Sylës me dashamirësi, nëse mendon që mundet me hek ndonjë emër tash, sepse me dy emra është e vështirë, merrne propozimin me shty sepse ne sa e murrum vendimin që ti hedhë posht ata ky dy. Kur të bien dakord me i pru ka një emër, ne mundemi me e votu.

Rrahim Morina: Qdo subjekt politik e ka politikën e vet, e organizon dhe e zhvillon atë të veten. Unë po kërkoj ta gjejmë një mirëkuptim, të dalim nga kjo situatë.

Hashim Vrenezi: Ne si PDK e përkrahim qëndrimin e vendimit që e kemi marrur më herët që e kemi marrur më herët dhe e ndryshuam sot, që secila parti politike të përfaqësohet nga një anëtarë. Faleminderit!

Sylë Dukolli: Ne nuk votojmë, grupin tonë e ftoj me dal jashtë. Përndryshe tash kemi me shku në rotacion edhe për komisionet e përhershme dhe kemi mu mbledh kujt i takon nga një plus, ishalla asnjë sna bjen neve. Mirëpo tash krejt mu knaq veq na jo. Nëse e qet në votim i ftoj jasht me dal.

Halil Morina:Dikush qëllimish po përpiqet me komplikuar, me na dhënë leksione për demokraci. Ju e keni përdorur një qelës ne 2017 qysh janë formuar komitetet, i keni formuar dhe na keni lënë do vene të rezervune, që ne sot kemi shpreh vullnetin me i plotësuar ato vende të rezervume. Në qoftëse ka ndrruar situatata ne ende i kemi këto komitete.Ne sot dojm me i plotësuar këta emra, atëherë në mbledhjen e ardhshme na vjen me material neve udhëzimi i ri dhe ne e sqarojmë mirë bashkë me ligjin për qeverisje lokale, cila është formula e re.

Rrahim Morina:14 jemi prezent, korum skemi.Kalofshi mirë,diten e mirë.

Mbledhja përfundoi në ora 16:20

Procesmbajtësja:

Albina Zulfaj-Morina

Albina Zulfaj

Kryesuesi i Kuvendit:

Rrahim Morina

Rrahim Morina